



Raport Vjetor 2022

Adresa:

Co-PLAN, Rruga Bylis 12, Kashar, P.O. Box 2995, Tirana, Albania

www.co-plan.org

co-plan@co-plan.org

© Ky Raport, përfshirë imazhet dhe tekstin, nuk mund të riprodhohet ose ndryshohet, në tërësi ose pjesërisht, pa miratimin paraprak të Co-PLAN.

25 vite Co-PLANing (6 - 15)

Rreth nesh (16 - 21)

Ekipi ynë

Aktivitete 2022

(Fq. 24 - 43)

Praktikat e mira në W2E në Selanik - W2E (24)

Vizitë Studimore në Bruksel - ideAL (26)

Dita Kombëtare e Aktivizmit - #nad2022 - SAIL (28)

Zëri ynë ka rëndësi - SAIL (28)

Mbështetje me investime për bashkitë në vend - RDPA (34)

Forumi Kombëtar Mjedisor - Green-AL (36)

Status Raporti për vitin 2022 - Financat Publike Vendore (38)

Ceremonia e ndarjes së granteve - EU4M (40-42)

Projekte 2022

(Fq. 44 - 108)

1. W2E - Nga Mbetje në Energji për Industrinë e Çimentos në Ballkanin Perëndimor (44 - 51)

Investimet në mjedis, investime strategjike për ekonominë, mirëqënien dhe të ardhmen e qëndrueshme - Konferencë studentore (51)

Partneritete lokale për rishikimin e Planeve Lokale të Menaxhimit të Mbjetëve Urbane (51)

Takime me Organizatat e Shoqërisë Civile, Median dhe Komunitetin (51)

Takimi i 3-të i Grupit Kombëtar të Punës dhe Prezantimi i Rezultateve Finale të Projektit (51)

2. RDPA - Programi i Zhvillimit Rajonal Albania IV (52-57)

Ngritja e Kapaciteteve për Pushtetin Vendor – një grup i vazhdueshëm trajnimesh (56)

Skema e Granteve të RDPA – Aktivitetet e Inagurimit (57)

3. ideAL - Dialog për Zhvillimin e Politikave Gjithëpërfshirëse të Bazuar në Dëshmi në Shqipëri (58 - 63)

Advokim dhe ndërgjegjësim për ndryshimet klimatike dhe një marrëveshje e gjelbër për Shqipërinë - Forum Kombëtar (63)

Reforma e Administratës Publike: Si të rritet efikasiteti i reformës strukturore - Forum Kombëtar (63)

4. FINANCATVENDORE.AL - Financat Publike Vendore (66-67)

5. GreenFORCE - Nxjtja e Ekselencës në kërkimin Shkencor për Tranzicionin e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor (68 - 73)

Ceremonia e fillimit të projektit GreenFORCE (71)

Përgatitja e Planit të Publikimit të Kërkimeve Shkencore dhe Agjendës së Përbashkët Strategjike të Kërkimit (71)

Punësoria e Bashkë-Dizenjimit që kontribuon në Konceptualizimin e Tranzicionit të Gjelbër të Drejte në Ballkanin Perëndimor (71)

6. SAIL- Sparking Activism Initiatives Locally (74 - 79)

Programi #shkëndija 2022 (78)

7. Green -AL - Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri (80 - 85)

Perspektiva gjinore në Organizatat e Shoqërisë Civile (84)

Mbështetje tematike dhe financiare e organizatave të shoqërisë civile përmes skemës së granteve (84)

8. WBC-RRI.NET - Zhvillimi i Kërkimit dhe Inovacionit të Përgjegjshëm në vendet e Ballkanit Perëndimor: Përmirësim i ekosistemeve të Vetë-Qëndrueshme të Kërkimit e Inovacionit (86-91)

Workshop i 1-rë i bashkë-projektimit në Lagunën Kune-Vain-Tale (90)

Workshop i 2-të i bashkë-projektimit në Lagunën Kune-Vain-Tale (90)

Pilotimi i shkencës qytetare dhe praktikave të tjera të RRI në Ekosistemet e Shqipërisë,

Workshop 3-7 Tetor 2022 në kuadër të Javëve së Arkitekturës në Tiranë, Going High! Të mirat dhe të këqijat e Valorizimit të qytetit (91)

Realizimi i matjeve për Shërbimin e Sekuestrimit të Karbonit në Pyllin e Pishave të

Lagunës Kune-Vain (91)

9. EU4M - EU4Municipalities (93)

10. Professional Fellows - Programi GLC Professional Fellows – Fuqizimi i Demokracisë së Udhëhequr nga Qytetarët (94-97)

Pesë pjesëmarrës të delegacioneve të vitit 2020 shkuan në Shtetet e Bashkuara (96)

Mentorë nga Shtetet e Bashkuara vizituan Shqipërinë në Shtator 2022' (96)

Pesë Shqiptar shkuan në SHBA si pjesë e grantit PF23 (96)

Ribashkimi i 6-të ndërkombëtar i alumni të programit në Budapest dhe Pecs, Hungari (96)

11. Punësimi Sezonal - Kushte më të mira punësimi për punëtorët sezonal në Shqipëri dhe Kosovë (98-103)

Kick off Meeting in Tirana – Drejt Reformës së punësimit sezonal në Shqipëri (103)

Takime mes aktorësh institucional në Kosovë – Hartimi i Analizës Kombëtare të

Punësimit Sezonal (103)

12. Emergjencat Civile - Projekti për komunikimin e emergjencave - Ndërgjegjësimi për rrezikun dhe siguria e qytetarëve (104-109)

Kurs trajnimi mbi Komunikimin në Emergjencë: Ballafaqimi me Tërmete dhe Tsunami (108)

25 vite Co-PLANing

Ky vit shënon 25 vjetorin nga dita kur Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit filloi zyrtarisht rrugëtimin si Organizatë e Shoqërisë Civile. Ka qenë një rrugëtim emocionues nga një ‘kontejner’ i improvizuar si zyrë me 4 persona të vendosur në zonën informale të “Breglumasi” pak jashtë kryeqytetit, në një organizatë të konsoliduar të vendosur në zemër të Universitetit POLIS - Institucioni simotër, me një ekip që numëron mbi 25 profesionistë.

Co-PLAN, që nënkupton ‘collaborative planning’ - planifikim në bashkëpunim, u themelua si një organizatë që synonte të nxiste planifikimin me pjesëmarrje, një gur themeli ky për qeverisjen e mirë urbane. Fillimisht të vendosur në Tiranë, ekipi nismëtar i Co-PLAN filluan punën në dy vendbanimet e mëdha informale, Bathore dhe Breglumas. Këto ishin projektet e para pilot të përmirësimit urban me një qasje të kombinuar sociale dhe investimesh në infrastrukturë. Gradualisht, praktikat e organizatës u orientuan nga vendbanimet informale periferike drejt lagjeve formale dhe qendrës së qytetit. Zhvendosja drejt Agjendave të Zhvillimit të Lagjeve (Neighbourhood Development Agenda) nënkuptonte punë të drejtpërdrejtë të komunitetit dhe drejtuesve vendorë për të ngritur struktura funksionale demokratike të përfaqësimit të komunitetit përmes veprimeve konkrete për përmirësimin në aspektin urban dhe social. Duke qenë pionier në qasjen e tij, Co-PLAN rikrijoi planifikimin e qytetit në një shoqëri me urrejtje të trashëguar për “planifikimin si koncept” për shkak të ndjeshmërisë ndaj qëndrimeve të centralizuara të planifikimit në të shkuarën. Si pjesë e praktikave, Co-PLAN prezantoi Ushtrimet Urbane në proceset e ndërmjetësimit dhe partneriteteve me autoritetet lokale dhe komuniteteve.

Vitet 2000 shënuan zhvillimin e modeleve të “Qeverisjes së Mirë Urbane” të pilotuara në Bashkitë Elbasan dhe Fier si pjesë e programi ‘Enabling Good Urban Governance’. Së bashku me kryetarët e rinj të bashkive, Co-PLAN sfidoi ‘status quo’-në e planifikimit fizik dhe prezantoi një qasje gjithëpërfshirëse të planifikimit urban, të shoqëruar me një sërë instrumentesh, si: planifikimi strategjik me pjesëmarrje për të përcaktuar objektivat e zhvillimit; plani i investimeve kapitale për të siguruar infrastrukturën kyçe që orienton zhvillimin urban (dhe jo anasjelltas); planifikimi i përdorimit të tokës që i mundëson bashkisë të jetë administratore e interesave publike ndërsa mundëson zhvillime private; sistemet e menaxhimit të informacionit për të ndihmuar bashkinë të kryejë analiza; projeksionet dhe vendimmarrjen e informuar.

Përpjekjet për zhvillim dhe integrim u intensifikuan dhe u materializuan në formën e projekteve dhe platformave të politikave, si dhe përpjekjet për zhvillimin e burimeve njerëzore të kualifikuara. Në vitet 2003-2005 Co-PLAN hartoi një Platformë për Qeverisjen Kombëtare të Territorit, me fokus në reformimin e sistemit të planifikimit, rajonalizimin dhe formalizimin e vendbanimeve informale. Platforma iu dorëzua Kuvendit të Shqipërisë duke hapur kështu një debat politik dhe publik. Në t

Duke i shtuar punës së zhvillimit dhe duke reflektuar mbi nevojën për një masë kritike ekspertize në disiplina të ndryshme që lidhen me ndërtimin e qytetit, qeverisjen e mirë dhe mjedisin, në vitin 2006 Co-PLAN themeloi Universitetin POLIS, një institucion i arsimit të lartë po aq pionier në qasje ndaj akademisë dhe kërkimit shkencor, fillimisht i fokusuar në arkitekturë, planifikim urban, dizajn arti dhe studime mjedisore. Sot, Universiteti POLIS renditet ndër universitetet më të mira në vend, me akreditim kombëtar dhe ndërkombëtar.



Në vitin 2018, Co-PLAN krijoi Rrjetin e Ballkanit Perëndimor për Qeverisjen Territoriale (TG -WeB), si një platformë që synon të çojë përpara kërkimin mbi qeverisjen territoriale në vendet e Ballkanit Perëndimor duke bashkuar forcat kërkimore dhe ndikuese të politikave nga rajoni. Sot rrjeti numëron mbi 20 anëtarë dhe punon në ndërmarrjen e kërkimeve dhe advokimit të politikave pioniere në të gjithë rajonin, për të përmirësuar qeverisjen e brendshme territoriale dhe ndikimin në një 'zë unik' integrimin në BE të vendeve të rajonit nga perspektiva e qeverisjes territoriale. Rrjeti është aktiv dhe ka një revistë periodike të quajtur "Rishikimi vjetor i qeverisjes territoriale në Ballkanin Perëndimor".

Me maturimin e tij, Co-PLAN ka marrë një rol aktiv në procesin e fuqizimit të shoqërisë civile, përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe programeve të mentorimit me fokus në organizimin e komunitetit, aktivizmin, avokimin dhe ndikimin në politika. Ky maturim ka bërë që Co-PLAN të angazhohet po me aq sukses në projekte rajonale, projekte kërkimore HORIZON2020, në tema të rëndësishme si Tranzicioni i Gjelbër.

Përparimi i një misioni të tillë organizativ nuk do të ishte i mundur pa ekipin e Co-PLAN, puna e palodhur dhe përkushtimi i të cilit ka qenë i admirueshëm. Në mënyrë të ngjashme, Co-PLAN nuk do të kishte qenë ajo që është pa mbështetjen dhe besimin e organizatave të ndryshme donatore duke filluar nga Cordaid që ndihmuan në themelimin e Co-PLAN, për të vijuar me Ambasadën Hollandeze, Agjencinë Austriake për Zhvillim, USAID-in, Ambasadën e SHBA-ve, Bashkëpunimin Zviceran për Zhvillim, Bankën Botërore, Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, etj., të cilat ndanë të njëjtat objektiva dhe vlera zhvillimi dhe mbështetën përpjekjet tona transformuese. Ne vlerësojmë gjithashtu punën dhe partneritetin me organizatat lokale, drejtuesit e komuniteteve ku jemi angazhuar, organizatat partnere dhe bashkitë në të gjithë vendin, ku kanë ndodhur dhe një pjesë e mirë e ndërhyrjeve tona transformuese.

Rruga e transformimit urban modern të Shqipërisë dhe jo vetëm, është ngushtësisht e lidhur me vitet 1990-të. Rënia e një sistemi të centralizuar diktatorial shënoi fillimin e një qasjeje

laissez faire



Qyteti i Nevojave Bazike >>>

Zhvillim apo Infrastrukturë? >>>



○
1990

Ndërkohë, disa profesionistë të rinj shqiptarë me një përvojë në fushën e inxhinierisë dhe arkitekturës, të arsimuar në jashtë shtetit, u kthyen në Shqipëri dhe themeluan organizatën e parë për kohën me këtë fokus.



Hapat e parë të Integrimit Social >>>



Planifikim me Pjesëmarrje >>>



Ditët e para të Organizatës së re Co-PLAN >>>

1995

1997

Organizata e re prezantoi praktika eksperimentale të planifikimit urban në zonat informale në Shqipëri, duke filluar me Bathoren, Breglumasin dhe Kenetën (Durrës). Kjo periudhë shënon një fazë konsolidimi për Shqipërinë; zhvillim dhe integrim në strukturat politike evropiane dhe atlantike.

Making Cities Work!



Vizita e Presidentit të Bankës Botërore në atë kohë, James Wolfensohn në vitin 1999 në një nga zonat informale shënoi një pikë kthese për diskutimin politik.

<<<



Mirënjohje nga komuniteti për punën e palodhur të Co-PLAN në terren >>>



Puna për integrimin social u shtri dhe në zona të tjera informale. Zona e ish-Kënetës në qytetin Durrësit shënon një rast ikonik >>>



○
1998

Kjo periudhë reflektimi për Co-PLAN theksoi nevojën për një masë kritike të kualifikuar me njohurinë dhe ekspertizën e duhur në planifikim dhe arkitekturë, si dhe nevojën për të ndikuar në nivelin e hartimit të politikave. Në vitin 2006 u themelua Universiteti Polis.

Modelet e para të Qeverisjes së Mirë Urbane u pilotuan në Bashkitë Elbasan dhe Fier >>>



Në vitin 2006 Co-PLAN themeloi Universitetin POLIS, një institucion i arsimit të lartë po aq pionier në qasje ndaj akademisë dhe kërkimit shkencor, fillimisht i fokusuar në arkitekturë, planifikim urban, dizajn arti dhe studime mjedisore.

V
V
V



2006

2009


Nga Ligji i Planifikimit, tek Reforma e Rajonalizimit



Vitet 2010 shënojnë një kontribut të rëndësishëm të Co-PLANit në legjisllacionin e ri të planifikimit. Ligji i ri dhe aktet nënligjore ndërtonin në shumë nga instrumentet bashkëkohore të planifikimit hapësinor dhe manaxhimit të tokës, advokuar nga Co-PLAN prej vitesh.

2010

...drejt Ndikimit të Politikave & Politikëbërjes në vend!



<<< Në vitin 2013 Co-PLAN përgatiti dhe ndau publikisht propozimin për rajonalizimin dhe zhvillimin rajonal në Shqipëri, një kontribut thelbësor në diskutimet e asaj kohe.

Dhjetë vjet dhe shumë sfida më pas, u miratua ligji i “Zhvillimit dhe Kohezionit Rajonal” në 2022, një moment historik që me vullnet të mirë politik, fuqizon aktorët rajonalë për të përcaktuar prioritetet rajonale dhe për të nxitur zhvillimin e balancuar rajonal. Ky ligj shënon një tjetër arritje me rëndësi për Co-PLAN.

<<< Në vite, Universiteti POLIS u konsolidua si institution i arsimit të lartë, duke u shndërruar në një partner strategjik dhe bashkëpunëtor në një numër nismash projektsh të përbashkëta.



V
V
V

2022

Presioni, gjykimi dhe debatet kanë qenë një pjesë e pandashme e udhëtimit tonë. Co-PLAN ka zgjedhur të qëndrojë pranë interesit të publikut dhe komunitetit. Sot, synojmë të promovojmë modele të planifikimit hapësinor dhe qeverisjeje europiane në përputhje me

orientimin & direktivat




Fuqizimi i Shoqërisë Civile për t'u angazhuar në procese dialogu me aktorë shtetërorë

V
V
V



Themelimi i Rrjetëve Rajonale si TG-WeB për të faktorizuar zërin tonë në procese të rëndësishme në nivel politikëbërje në BE.

V
V
V




Në vitin 2018, u themelua Dita Kombëtare e Aktivizmit - NAD dedikuar nismave të aktivistëve kudo në vend.

2014

Co-PLAN ka propozuar platforma të reja për aktorët politikë në vend, duke nxitur debate. Disa sugjerime tashmë janë materializuar në një sërë nismash ligjore, ndërsa të tjera janë në themel të debateve politike, me shpresën që këto ide do të shndërrohen në politika të zbatueshme.

e Bashkimit European.



Prej disa virtesh Co-PLAN angazhohet në projekte rajonale, projekte kërkimore HORIZON2020, në tema të rëndësishme si Tranzicioni i Gjelbër.

2022

rreth nesh

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit është një organizatë jofitimprurëse që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm, në qeverisjen e mirë urbane dhe rajonale, duke trajtuar çështjet kyçe mjedisore, zhvillimin e shoqërisë civile, si dhe duke ndikuar politika dhe promovuar pjesëmarrjen e komunitetit që nga viti 1995. Në thelb të aktivitetit tonë është puna me njerëzit dhe institucionet, për të nxitur transformim të prekshëm social dhe ndryshime pozitive në terren, duke prodhuar njohuri promovuese për një menaxhim më të mirë të habitatit. Co-PLAN përmbush misionin e tij përmes aktiviteteve pilot dhe shërbimeve këshilluese, të cilat lancohen nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përfshirjes së drejtpërdrejtë me komunitetet, njësitë e qeverisjes vendore dhe organizata të tjera joqeveritare në fushën e manaxhimit urban dhe rajonal, manaxhimit të mjedisit dhe financave komunale. Edhe pse jemi të bazuar në Tiranë, Shqipëri, kemi zhvilluar një rrjet të gjerë projektesh në terren në nivel rajonal dhe kombëtar.

Puna kërkimore dhe konsultative e Co-PLAN ndërtohet mbi katër fusha ekspertize: Zhvillimi Urban dhe Rajonal, Manaxhimi i Financave Publike, Manaxhimi i Mjedisit Urban dhe Punë Kërkimore, si një element i integruar në të gjitha fushat. Secila ekspertizë trajtohet nga ekiye të dedikuara. Co-PLAN ka një eksperiencë të gjatë dhe një portofol të gjerë kërkimor në çështjet që kanë të bëjnë me fushat tona tematike, veçanërisht në fushën e vlerësimeve mjedisore, menaxhimit territorial, përgatitjes së planeve strategjike dhe strategjive zhvillimore; Përgatitja e planeve rregulluese urbane; Ofrimi i shërbimeve të qeverisjes vendore; Integrimin e vendbanimeve informale, etj. Në vite Co-PLAN ka realizuar rreth 200 projekte në Shqipëri dhe rajon, kryesisht të financuara nga agjencitë financuese dhe institucionet si Komisioni Evropian, UNDP, USAID, Banka Botërore, Qeveria Holandeze, Agjencia e Zhvillimit, etj.

ekipi ynë



Dritan Shutina
Drejtör Ekzekutiv



Anila Bejko
Zëvendës Drejtoreshë
Ekzekutive e Co-PLAN
/ Eksperte e Qeverisjes
Territoriale



Rudina Toto
Eksperte e Lartë
dhe Hulumtuese në
Qeverisje Territoriale
dhe Manxhim Mjedisor



Ogerta Gjknuri
Drejtuese e Njesisë
së Financës dhe
Administratës



Aida Ciro
Eksperte për Shoqërinë
Civile/ Turizëm



Merita Toska
Eksperte për Zhvillimin
Ekonomik dhe Financiar



Rodion Gjoka
Ekspert për
Manaxhimin Mjedisor



Kejt Dhrami
Eksperte dhe Hulumtuese
për Planifikimin Hapësinor
dhe Urban



Ledjo Allkja
Ekspert dhe Hulumtuese
për Planifikimin Hapësinor
dhe Urban



Imledi Sokoli
Ekspert për
Planifikimin Urban



Fiona Imami
Eksperte dhe Hulumtuese
për Qeverisjen Territoriale



Rudina Pasholli
Eksperte për Shoqërinë
Civile



Daniela Kostandini
Eksperte Komunikimi



Sara Korreshi
Eksperte Junior për
Manaxhim Mjedisor



Erinda Dheskali
Eksperte Financash
/Asistencë Projekti



Elvis Ndreka
Ekspert për Manaxhimin
Mjedisor



Besmir Geziqi
Ekspert për Manaxhimin
Mjedisor



Klesta Galanxhi
Eksperte për Dizajn
Grafik



Erni Kocani
Ekspert për Manaxhimin
Mjedisor



Rea Muka
Eksperte Junior për GIS
dhe Planifikim Urban



Enkela Poro
Inxhiniere Mjedisi dhe
Hulumtuese



Androniqi Nini
Eksperte Financash
/Asistencë Projekti



Arba Balla
Asistente Ekzekutive



Altion Qirko
Logjistikë

Stafi i Co-PLAN-it përbëhet nga ekspertët më të mirë në fushat që përfaqësojnë që me ekspertizën e tyre i shtojnë vlerë organizatës. Ata janë të rinj, energjikë dhe vijnë nga prejardhje të ndryshme duke përfaqësuar më së miri filozofinë e punës së Co-PLAN. Stafi i Co-PLAN është i kualifikuar në disa fusha tematike: menaxhimi urban dhe rajonal, menaxhimi i financave komunale, menaxhimi i mjedisit urban si dhe fushën kërkimore. Një pjesë e ekspertëve tonë kanë përfunduar studimet e tyre në universitete ndërkombëtare, kryesisht në institucione dhe institutet hulumtuese të shquara akademike.

200+

PROJEKTE TE ZBATUARA NE
SHQIPERI, NE BALLKANIN
PERENDIMOR DHE NIVEL
EUROPIAN.







aktivitete 2022



Vizitë Studimore e Nivelit të Lartë në Fabrikën e Çimentos Titan, Selanik

Përgjatë muajit nëntor, u zhvillua një vizitë studimore me qëllim shkëmbimin e përvojave nëpërmjet teknologjive të reja të cilat Titan Antea Thessaloniki ka zbatuar me sukses për përdorimin e lëndëve djegëse alternative.

Nëpërmjet kësaj vizite studimore, ekipi i projektit, synonte të ndikonte drejtpërdrejtë tek politikëbërësit, vendimmarrësit, duke u paraqitur një panoramë të qartë se si procesi i rekuperimit, i cili është një koncept brenda hierarkisë së mbetjeve, është një mundësi shumë e mirë si në aspektin mjedisor ashtu edhe në atë ekonomik përkundrejt statusit të dobët të sektorit të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Pjesë e vizitës studimore ishte edhe vizita e kryer në impiantin e prodhimit të lëndëve djegëse alternative, pranë fabrikës së çimentos Titan Selanik, për të parë procesin e përdorimit të lëndëve djegëse alternative dhe për të krijuar një koncept të qartë për mënyrën e funksionimit dhe mundësitë e realizmit dhe ngritjes së këtyre teknologjive në vendin tonë.

Në këtë aktivitet morën pjesë afërsisht 40 persona të cilët ishin përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, kryetarë të bashkive, përfaqësues të subjekteve të angazhuara me menaxhimin e mbetjeve si dhe përfaqësues të mediave.





Vizitë studimore në Bruksel

Si pjesë e zhvillimit të kapaciteteve të ofruar për Organizatat e Shoqërisë Civile, u organizua një vizitë shkëmbimi në Bruksel (Belgjikë) përgjatë muajit nëntor 2022. Qëllimi i vizitës së shkëmbimit ishte njohja, të kuptuarit dhe përfshirja në proceset e ndikimit të politikave dhe dialogut në nivel të BE-së. Organizata të shumta me performancë të lartë në skemën e granteve të ofruara nga projekti ideal, morën pjesë në vizitën e shkëmbimit, duke përfshirë: Instituti për Studime Publike dhe Lokale përfaqësuar nga znj. Eralda Cani Methasani, Together for Life - përfaqësuar nga znj. Denisa Canameti, Shoqata Illiria përfaqësuar nga z. Abdulla Diku, DMO Albania përfaqësuar nga znj. Eva Kushova, HDPC përfaqësuar nga znj. Elena Polo, dhe Qendra T'reja përfaqësuar nga znj. Ferdiola Rushiti.

Kjo vizitë studimore u organizua nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Qendrën e Politikave Evropiane (EPC), duke krijuar mundësinë e angazhimit dhe dialogut me institucionet me rëndësi për procesin e negociatave si:

- Z. Vlad-Marius Botoș Eurodeputeti a-Kryetar i Komisionit të Parlamentit Evropian për Zhvillimin Rajonal dhe Zëvendës Kryetar i Delegacionit të PE në Komitetin Parlamentar të Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri
- Z. Janis A. Emmanouilidis, Drejtor i Studimeve, nga EPC mbi 'BE në një pikë kthese në histori'
- Z. Stefan Sipka, Analist i Politikave, nga EPC mbi 'Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane', Rruga e Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE.

Organizatat pjesëmarrëse patën mundësinë të angazhohen në diskutime dhe të drejtojnë pyetje. Disa nga mesazhet kryesore të përcjella dhe të theksuara nga shumica e të ftuarve ishin rëndësia e kërkimit solid dhe të vazhdueshëm; nevoja për të angazhuar dhe faktorizuar hulumtimin e politikave, propozimin dhe rekomandimet, etj.

Nisur nga gjendja aktuale e punëve në Shqipëri, u diskutua dhe u konkludua se një nga takimet thelbësore do të duhej të zhvillohej në Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit Evropian - Drejtoria e

Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) me përfaqësues Z. Alberto Cammarata, Drejtues i Komanduar i Njesisë, Z. Vincent Rey, Drejtues i Ekipit për Negociatat e Anëtarësimit, nga DG NEAR, Komisioni Evropian për "Procesin e integritetit të Shqipërisë në BE dhe sfidat".

Gjatë seminarit, z. Cammarata dhe z. Rey theksuan rëndësinë e përmbushjes së detyrimeve në funksion të procesit të integritetit në BE, me fokus të veçantë në procesin e shqyrtimit, ku bashkëpunimi i aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetëror konsiderohet vendimtar. Z. Cammarata vuri në dukje faktin se gjetjet nga procesi i shqyrtimit janë thelbësore dhe se afati kohor në lidhje me 'kur pritet Shqipëria' të anëtarësohet në BE lidhet shumë me gatishmërinë e qeverisë për të përmbushur dhe për t'iu përgjigjur detyrimeve që rrjedhin nga procesi i shqyrtimit.

Pjesëmarrësit në seminar patën mundësinë të ndërveprojnë drejtpërdrejt me tre zyrtarët e BE-së duke pyetur gjithashtu për çështjet që kanë të bëjnë me sfidën e faktorizimit të punës së tyre në procese të tilla, veçanërisht në rastin e zyrtarëve që nuk janë shumë të gatshëm të miratojnë praktikisht rekomandimet që vijnë nga OSHC-të. Zyrtarët e BE-së theksuan gjithashtu rëndësinë që të bëheni vazhdimisht dhe me durim pjesë e proceseve të tilla dhe të angazhoheni drejtpërdrejt me strukturat e BE-së.

Një pjesë shumë interesante për të gjithë pjesëmarrësit ishte punësoria e politikave "BE në një pikë kthese në histori" e drejtuar nga Drejtori i Studimeve në Qendrën e Politikave Evropiane - Janis A. Emmanouilidis. Punësoria u ofroi pjesëmarrësve një rezymë shumë të detajuar mbi faktorët ndikues në skenën e politikave të BE-së dhe se si proceset në Ballkanin Perëndimor ndikohen nga kjo. Organizatat pjesëmarrëse kuptuan rëndësinë e hulumtimit të qëndrueshëm të politikave dhe rëndësinë e analizës së politikave përtej kontekstit lokal ose rajonal.



Dita kombëtare e Aktivizmit - #nad2022

Krahas programit #shkëndija, një element shumë i rëndësishëm në projekt është Dita Kombëtare e Aktivizmit, një ditë e përkushtuar për të çmuar aktivizmin qytetar të të gjitha formave me një gjeografi që shtrihet në të gjithë vendin duke i bërë jehonë rëndësisë së aktivizmit qytetar dhe rolit të tij thelbësor në ndërtimin e një demokracie të shëndetshme.

Viti 2022 shënoi 5-vjetorin e Ditës Kombëtare të Aktivizmit. Për 5 vitet e fundit, mbi 160 organizata lokale, aktivistë si dhe aktorë të mirënjohur brenda skenës së shoqërisë civile janë bërë pjesë e #NAD përmes aksioneve praktike të organizuara në bashki të ndryshme të vendit, apo pjesëmarrjes në panaiet e shoqërisë civile të mbajtura në Tiranë.

Më 21 dhe 22 tetor u bashkuam dhe festuam Ditën Kombëtare të Aktivizmit #nad2022. Për të pestin vit rradhazi, organizata, shoqata, grupe dhe aktivistë individualë që veprojnë në të gjithë territorin shqiptar u bënë pjesë e aktiviteteve të organizuara me këtë rast.

Angazhimet dhe reagimet e tyre ndër vite, si një shembull i mirë qytetarie u pasqyruan në një dokumentar të shkurtër në eventin e mbajtur pranë Qendrës Kulturore të Kompleksit të Katedrales Orthodhokse në Tiranë.

Histori frymëzuese nga aktivistë vendas e të huaj u bashkëndanë për të pranishmit, si ato të humanitarit dhe mjekut portugez Gustavo Carona de Magalhães, arsimtares Florida Kumanaku, menaxherit kulturor dhe akademikut nga Italia Paolo Petrocelli, si dhe aktivistit dhe gazetarit Geri Emiri.

Veprimtari të shumta u organizuan anembanë Shqipërisë, duke kulmuar në shkollën 9-vjeçare “Ferraj”, në Tiranë. Në këtë shkollë të Njesisë Administrative Dajt, u inaguruan punimet përmirësuese në infrastrukturën e mjedisit të jashtëm, me fokus fushën sportive dhe gjelbërimin. E konceptuar edhe si një ditë në shërbim të nxënësve dhe komunitetit në Ferraj, qytetarë

aktivistë dhe organizata të ndryshme kontribuan përmes trajnimit të stafit, kurseve aftësuese dhe aktiviteteve informuese për nxënësit, dhurimit të mjeteve didaktike, këndeve informuese, pajisjeve sportive, librave shkollorë dhe artistikë për fëmijë. Dita Kombëtare e Aktivizmit #NAD2022 u realizua në kuadër të projektit “Sparking Activism Initiatives Locally – SAIL II”, i zbatuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit me mbështetjen e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Ambasadën Amerikane U.S. Embassy-Tirana, si pjesë e programit “Civil Society Capacity Building”.

Zëri ynë ka rëndësi

Kishim kënaqësi që në bashkëpunim me partnersalbania të organizonim aktivitetin “Zëri ynë ka rëndësi” ku u prezantuan histori nismash të suksesshme nga #shkëndijat dhe organizatat e shoqërisë civile, të mbështetura nga programi “Ngritja e Kapaciteteve të Shoqërisë Civile”.

I pranishëm në këtë aktivitet z. Chad Twitty, drejtues i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, vlerësoi kontributin dhe punën e bërë në përmirësimin e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë financiare të organizatave, si dhe aftësitë advokuese të aktivistëve të rinj për të sjellë ndryshime pozitive në komunitet.

Në këto afro dy vite përmes zbatimit të këtij programi kanë marrë jetë

ide dhe nisma të padëgjjuara më parë, të cilat kanë ndikuar në kultivimin e një kulture qytetare aktive dhe zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile.

Ky program i mundësuar nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë do të vijojë me faza të mëtejshme për të mbështetur individët, aktivistët dhe organizatat kudo në Shqipëri duke synuar të sjellë ndikim në shoqëri.









5 vjet #nad



Për 5 vitet e fundit, mbi 160 organizata lokale, aktivistë si dhe aktorë të mirënjohur brenda skenës së shoqërisë civile janë bërë pjesë e #NAD përmes aksioneve praktike të organizuara në vend, pjesëmarrjes në panaireset e shoqërisë civile të mbajtura në lokacione qendrore në Tiranë.

Mbështetje përmes Skemës së Granteve për 16 bashki në vend

Gjatë fazës së IV-të, Programi për Zhvillimin Rajonal Shqipëri publikoi 2 Skema Grantesh, të cilat targetonin të 61 bashkitë e Shqipërisë dhe mundësuan një alokim financiar prej 3.6 milion CHF, i cili u ndoq me zbatimin dhe inagurimin me sukses të 18 projeteve gjatë vitit 2022!

Skema e parë e granteve targetoi bashkitë e prekura nga tërmeti, dhe financoi 8 projekte në mbështetje të komuniteteve për të adresuar sfidat zhvillimore komplekse të rimëkëmbjes. Projektet e financuara dhe zbatuara përfshinin nga ripertëritja e infrastrukturës së kopshteve e cerdheve, rikonstruksione të qendrave kulturore e multifunkionale, e deri tek ndërtimi i urave lidhëse dhe infrastrukture.

Skema e dytë “Per Zhvillimin Rajonal dhe Kohezioni”, me një dimension më gjithëpërfshirës u bazua në nevojat prioritare dhe potencialet endogjete të rajonit të harmonizuara dhe identifikuar në Programin e Integruar për Zhvillimin Rural të 100+ fshatrave. Me një rekord aplikimesh në fazën e parë (55 bashki), PZHRSH, financoi 10 projekte përfituese të cilat rrisin potencialin ekonomik në rajone, nxisin turizmin e qendrueshëm dhe mbështesin zhvillimin social ekonomik të këtyre territoreve.





Forum Kombëtar Mjedisor

Më 5 Maj, 2022 partnerët e GreenAL organizuan për herë të parë Forumin Mjedisor i cili mbledhi mbi 50 përfaqësues të organizatave mjedisore në Shqipëri.

Në këtë forum morën pjesë edhe Ambasador Elsa Håstad in Albania, Zv. ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Znj. Ornella Çuçi, përfaqësues të European Union in Albania dhe GIZ Albania.

Gjatë këtij forumi pjesëmarrësit ngritën dhe diskutuan shqetësimet e tyre për problematikat mjedisore si ndryshimet klimatike, energjia, ndotja dhe mbrojtja e habitatit, të cilat kanë nevojë të adresohen me politika e veprime konkrete duke përfshirë të gjithë palët e interesit.

Më tej, u prezantuan disa nga projektet e mbështetura nëpërmjet skemës së granteve të #GreenAL, me anë të të cilave synohet përmirësimi dhe promovimi i mbrojtjes së mjedisit në vend.

Moment me rëndësi i punimeve të këtij forumi ishte firmosja e deklaratës së përbashkët të Organizatave të Shoqërisë Civile, nëpërmjet së cilës u kërkua që mjedisi të jetë një nga pesë prioritetet e agjendës së politikës kombëtare.

Pjesëmarrësit kërkuan që nga institucionet përgjegjëse të luftohet krimi mjedisor, të rritet transparenca dhe pjesëmarrja në vendim-marrje, të forcohet bashkëpunimi me OSHC-të, të krijohet një platformë me të dhënat mjedisore në nivel lokal dhe kombëtar, si dhe të nxitet kërkimi shkencor për të identifikuar impaktet e ndryshimit të klimës në mjedis.

Deklaratë e përbashkët e Organizatave Mjedisore në Shqipëri

Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri, duan të shprehin publikisht shqetësimin e tyre në lidhje me masat, politikat dhe investimet që ndiqen dhe kontribuojnë në të njëjtën degradim të statusit mjedisor të anës natyrore dhe urbane në Shqipëri.

Krimi mjedisor është më shumë se kurrë i pranishëm dhe i vështirshëm në të gjithë Shqipërinë. Komunitetet po u përballen me sfida për fuqizimin e procesit të planifikimit dhe vendimtarisë, si u rritet pjesa më e madhe e ndryshimit të ngjashmërisë së statusit mjedisor dhe nga ato publike mund të shpallin konflikt dhe përplasje me komunitetet.

Nëse kjo situatë komprometohet dhe kjo të vështirë të korrë suksesin e tyre, të tërësi për një moment dhe të imagjinohet se sa e vështirë është që abuzimet mjedisore dhe biodiversiteti të sigurojnë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi dhe burimeve të tyre, po për përballen nga të cilat një deputet në Parlamentin e Shqipërisë.

Duke qatur parasysh rrethanat e ndryshme të vendeve në të cilat po përballen, detyrë e domosdoshme që publiku të marrë mesazhin se ka ardhur koha për të shprehur kritikë, për të luftuar propagandën dhe politikanët e vërtetë në kurriz të masat. Duke qatur se shprehur publik, i rikthyer nga shtetë me vendime ekonomike kombëtare si energji, bujqësi, turizëm, planifikim hapësirë janë të gjitha nën presion të vazhdueshëm nga përfaqësues, ndoshta dhe ndryshimi i klimës, Shqipëria duhet të kthejë të vëmendjen në mënyrë të qartë dhe strategjike kundër këtyre rrethanave.

Komiteti i OSHC-ve Mjedisore kërkoi të ngrej zërin e kritikës në lidhje me përkrahimin e përditësimit të kësaj autoriteti publik, privat dhe komunitet në lidhje me:

Klimë dhe Energji

- Forcimi i kapaciteteve të pushtetit vendor nëpërmjet ngritjes së strukturave përgjegjëse për planifikim klimatike.
- Mbledhja e të gjithë palëve për të identifikuar ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe për të mbështetur vendimet e tyre.
- Zhvillimi i politikeve lokale për të rikthyer detyrat në nivelin që përveç rrethanave nga pasqyra e ndryshimeve klimatike.
- Përmirësimi dhe ndërtimi i alternativave të transportit publik.
- Zhvillimi i transicionit energjetik në Shqipëri sipas parimeve të Mbrojtjes së Qipër të BE-së.

Për sa i përket ngritjes dhe habitaveve, OSHC-ja janë shumë të shqetësuara për fundin e habitaveve dhe specielisht në zonat kryesore të biodiversitetit dhe në të gjithë vendin, si pasqyra e aktivitetit mjedisor në paqendueshmëri, përfaqësi urbanizimit, intensifikimit e aktivitetit mjedisor dhe burimeve të tyre.

OSHC-ja e merr të veshur se ndryshimi i klimës ka ndikuar në vendimet e tyre dhe në vendimet e tyre të biodiversitetit të jetë përfaqësi i vendit, të ndalojë vendimet e kaluar në zonat kryesore të biodiversitetit, të luftohet krimi mjedisor nga institucionet, të rritet transparenca dhe qëndrueshmëria në vendim-marrje dhe të forcohet bashkëpunimi me shoqëritë civile për një vendim-marrje më të qëndrueshme dhe për një pjesëmarrje aktive në procesin e hartimit të ligjeve.



Për ndotjen, krimeve:

- Krijimi e një platforme me të dhëna mjedisore në nivel lokal dhe kombëtar.
- Zhvillimi e vendimeve me pjesëmarrje të shtresave me ligj, përmes digjaveve publike.
- Përmirësimi i vendimeve të hartimit nga pushteti qëndror dhe vendor, për menaxhimin e burimeve, aqit, emergjencave civile, zhurmës, ajrit.
- Zhvillimi e "përgjegjësi me qeverisje të përditësuar".
- Krijimi e një metodologjie monitorimi mjedisor nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, duke të rritur nivelin e procesit konsultim me shoqëritë civile.

Në përfundim,

Nu, komuniteti i OSHC-ve Mjedisore në Shqipëri janë të shqetësuara nga mungesa e burimeve mjedisore dhe burimeve që ka autoriteti kryesor, si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në lidhje me përmirësimin e funksionimit të bashkëpunimit me legjislacionin kombëtar. Një situatë e kësaj më e pakënaq në rastin e agjencive dhe autoriteteve nacionale.

Zgjidhjet e përditësuar gjatë nga autoritetet kanë një kosto të lartë, por për më tepër në kurriz të qendrueshmërisë. Duke marrë parasysh faktin se energjia, turizmi, bujqësia e tërësi, menaxhimi i mbledhjeve apo ndotja e ajrit, ku ka një kosto më të lartë dhe monitorimi dhe raportimi për këtë çështje. Nga ana tjetër, sektorin privat, i përveç nga mungesa e vlerës agjencive publike për të respektuar detyrat për të bërë masat e nevojshme të rritjes, gjë kështu të përfaqësojë për të shprehur me aqsa që detyrim të përfaqësojë nga legjislacioni për të zbatuar dhe respektuar standartet në lidhje me parandamën dhe trajtimin e ndotjes.

Për referencë, në Tiranë janë më 20 mijë qytetarë të të gjitha moshave, grupet, gjinive dhe përfaqësues që janë të shqetësuar nga shprehja përfaqësojë shprehjen, në 3 mijë njerëz në Shqipëri vdesin për koha që do të vijnë, duke qatur kritikë dhe duke mos marrë pozicione aktuale pro e kundër apo kësaj e tjetër.

Nu, me të OSHC-ja janë të shqetësuar për një rritje në qatë kohë për të adresuar shqetësimet tona, me një kurriz mjedisor që po rritet përmes ajrit, turizmit, bujqësisë dhe tërësi të tjera që shprehin e autoriteteve jo vetëm në Shqipëri, por kudo në rajon dhe më gjatë, ngjashmëri të përmendur.

Nu si shoqëri civile, por si qytetarë më të gjitha, duan të themi STOP.

Nu nuk duan të bashkëpunojnë kurrë nga një sistem në jetën, nga një brez në jetën. Ne duan të angazhohemi dhe satifikojmë për zgjidhje të qëndrueshme.

Tiranë, 5 maj 2022
Forum Kombëtar i Mjedisit









Gjendja e Financave Publike Lokale ne vend për vitin 2022

“Raporti i Gjendjes së Financave Publike Lokale për vitin 2022” ofroi një pasqyrë detajuese të të ardhurave dhe shpenzimeve lokale, treguesve të decentralizimit dhe ngjarjeve që karakterizuan vetë-qeverisjen lokale gjatë vitit 2022. Performanca e financave publike lokale u analizua dhe u lidh me informacione nga burime të tjera për të paraqitur faktorët që mund të kenë kontribuar në zhvillimet e treguesve për të ardhurat dhe shpenzimet lokale. Mes debateve për rishikimin e kufijve territorialë, rishikimit të strategjisë për decentralizim dhe vet-qeverisje lokale dhe nën presionin e zgjedhjeve lokale (maj 2023), zhvillimet financiare në nivel lokal për vitin 2022 duket se stimuluan interesin e politikave, politikanëve dhe qytetarëve.

Raporti i Financave Publike Lokale - Raporti i Gjendjes së Vitit 2022 është pjesë e një serie raportesh periodike tremujore që përmbledhin zhvillimet në të ardhurat dhe shpenzimet e bëra nga 61 bashkitë në Shqipëri. Raporti është i strukturuar në dy seksione kryesore: (i) seksioni 2, i cili prezanton një analizë të detajuar të burimeve të financimit të 61 bashkive në vend, në total dhe sipas bashkisë; (ii) seksioni 3, duke prezantuar një analizë se si u alokuan burimet financiare të disponueshme nga 61 bashkitë në vend. Gjetjet kryesore nga Raporti i Gjendjes për vitin 2022 prezantohen në pjesën përfundimtare të këtij dokumenti. Anekset e bashkuara me këtë raport përmbajnë metodologjinë për klasifikimin e të dhënave dhe treguesve të përdorur në këtë analizë.”



‘Territorialja’ tryezë të përbashkë Toska: Janë ulur investimet e bashkive veta!

Shkruar nga Pamfleti





kët me OSBE-në,
bashkive me fondet e



LAJMET E FUNDIT

- 13/11 / ARDURISHTI**
Dritan Goxhoj kalëzon në SPAK ministrin Ulsi Marja
- 13/11 / KRONIKË**
Detaje të reja nga vrasja në Fier, policia kontrollon në gjithë qytet...
- 13/11 / KRONIKË**
Naimi inskenoi ekzekutimin, ekspertët zbulon hetimet: Do ketë deshm...
- 13/11 / KRONIKË**
Për 4 ditë vodhi tre biznese, kapet hajduti serial në Durrës, polic...



Ceremonia e ndarjes së granteve për 6 bashkitë fituese nga thirrja e parë

Gjashtë bashki shqiptare u shpallën fituese në thirrjen e parë të skemës së granteve të “BE për Bashkitë” të financuar nga Bashkimi Evropian. Me mbështetjen prej 1.1 milion euro, Bashkimi Evropian përmes kësaj skeme grantesh mbështet direkt ndërtimin, rivitalizimin dhe restaurimin e 11 objekteve arsimore, sociale, kulturore dhe tregtare në bashkitë Mat, Berat, Shkodër, Gjirokastrë, Pukë dhe Përmet ku përfitues kryesor janë të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël.

Projektet fituese u prezantuan përgjatë ceremonisë së firmosjes së granteve e organizuar në Bashkinë Mat me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, kryetarëve të bashkive dhe partnerëve të projektit “BE për Bashkitë”.

Në fjalën hapëse të kësaj ceremonie, drejtuesja e Sektorit të Qeverisjes së Mirë, Drejtësisë dhe Zbatimit të Ligjit në Delegacionin e BE-së në Shqipëri, znj. Lenka Vitkova theksoi rritjen e asistencës së BE-së ndaj pushtetit vendor në Shqipëri, e cila vjen si një nevojë për fuqizimin e kapaciteteve të bashkive pasi ato janë aktorët më të rëndësishëm në procesin e integritetit evropian.

“Roli i njësive të qeverisjes vendore për procesin e integritetit evropian mbetet me rëndësi pasi 3/4 e legjislacionit evropian zbatohet në nivel vendor. BE-ja ka rritur asistencën financiare në 34 milionë euro për bashkitë shqiptare dhe ka zgjeruar diapazonin e kësaj ndihme për bashkitë. Në këtë fazë është

shumë e rëndësishme për ne që të merremi me zhvillimin e kapaciteteve, në mënyrë që bashkitë të jenë të afta të zhvillojnë dhe zbatojnë projektet për të kontribuar në procesin e integritetit evropian”- tha ndër të tjera znj. Vitkova.

10% e vlerës së granteve për projektet fituese vjen edhe nga qeveria qendrore nëpërmjet bashkëfinancimit. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, z. Enea Hoti, në fjalën e tij garantoj se qeveria është gati për të alokuar të ardhurat për të gjitha bashkitë fituese në këtë thirrje ashtu si dhe shumë shpejt për bashkitë fituese në thirrjen e dytë.

I pranishëm në këtë ceremoni z. Kelmend Zajazi, drejtuesi i NALAS, Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore, vlerësoi kontributin e BE-së për të mbështetur skemën e granteve të “BE për Bashkitë” si një projekt pionier i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.

“Ne jemi këtu të krijojmë një trend të ri që së bashku me shoqatat e bashkive dhe delegacionin e BE-së të krijojmë programe dhe instrumente të tjera për përmirësimin dhe modernizimin e shërbimeve vendore, kjo është ajo çfarë presin qytetarët dhe të rinjtë. Zbatimi i projekteve nga programet e tilla ka një rëndësi të shumëfishtë dhe sidomos për vendet që kërkojnë që të bëhen pjesë e BE-së pasi ato nuk kanë nevojë të fillojnë nga zero, por përgatiten që tani njëlloj si vendet e tjera të BE-së”- deklaroi Zajazi.



Ceremonia e ndarjes së granteve për 6 bashkitë fituese nga thirrja e dytë

Ofrimi i shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve në nivel vendor përbën një sfidë dhe prioritet për bashkitë në vend. Në kushtet kur kompetencat dhe funksionet e bashkive në raport me qytetarët janë shtuar dhe kërkesat për fuqizim institucional rriten me hapjen e negociatave për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Europian prej korrikut të këtij viti, efikasiteti dhe zhvillimi i bashkive merr një peshë më të madhe.

Në këtë kuadër, dhe në vijim të mbështetjes për pushtetin vendor, programi #BEpërBashkitë (EU4Municipalities) shpalli sot 13 bashkitë fituese të granteve të thirrjes së dytë gjatë një ceremonie të zhvilluar në Bashkinë Lushnjë.

Drejtesja e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, Ambasadorja Christiane Hohmann i kërkoi kryebashkiakëve të pranishëm në ceremoni të bëhen zëri i qytetarëve, ndërsa ritheksoi rolin kyç të pushtetit vendor në anëtarësimin e vendit në BE. Kjo, duke patur parasysh se rreth 70% e përafrimit të kuadrit ligjor të BE-së në Shqipëri duhet të zbatohet në nivel lokal.

Drejtori i programit #BEpërBashkitë, Z. Elton Stafa u shpreh se për të patur sa më shumë thirrje të tilla dhe përfitues duhet punuar për ngritjen e kapaciteteve pranë bashkive.

Përfitues të grantit për një total prej 600 mijë eurosh janë bashkitë e Lushnjës, Skraparit, Patosit, Kucovës, Kamzës, Klosit, Kavajës, Tropojës, Rrogozhinës, Mirditës, Tiranës, Lezhës dhe Fushë-Arrëzit.







projekte 2022





WASTE2ENERGY

Nga mbetje në energji për industrinë e çimentos në Ballkanin Perëndimor

Periudha e Zbatimit: 01/03/2020 - 31/12/2022

Donator: German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development

Fondi: 365,120,00 EUR

Zbatuar nga: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Partneret zbatues: Antea Cement Sh.a, Cementarnica USJE AD,
Titan Cementara Kosjeric d.o.o., Co-Plan Institute for Habitat Development,
AMU Albanian Manufacturers Union, REC North Macedonia, RDA Zlatibor.

Zbatuar në: Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Serbi

Projekti **‘Nga Mbetje në Energji për Industrinë e Çimentos në Ballkanin Perëndimor’** ka si objektiv kryesor vendosjen e parakushteve për përdorimin e mbetjeve urbane, industriale dhe mbetjet e gomave të dala jashtë përdorimit për prodhimin e lëndëve djegëse alternative, duke zëvendësuar kështu lëndët djegëse fosile për prodhimin e çimentos në industrinë vendase të çimentos në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Përmes projektit, synohet të identifikohet potenciali i përdorimit të llojeve të ndryshme të mbetjeve në furrat e çimentos, duke ditur faktin se përdorimi i mbetjeve si lëndë djegëse alternative për bashkë-djegje është një proces i njohur për të siguruar zgjidhje të qëndrueshme për reduktimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve dhe ndërkohë reduktimin e lëndëve djegëse fosile të përdorura për prodhimin e energjisë në industrinë e çimentos. Ky projekt u zbatua nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Partneret zbatues: Antea Cement Sh.a, Cementarnica USJE AD, Titan Cementara Kosjeric d.o.o., Co-Plan Institute for Habitat Development, AMU Albanian Manufacturers Union, REC North Macedonia, dhe RDA Zlatibor.

Përgjatë zbatimit të projektit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, u arritën disa rezultate, ky veçojmë:

- Vlerësimin e potencialit të prodhimit dhe përdorimit të RDF (Lëndëve Djegëse të Refuzuara)/SRF (Lëndëve Djegëse të Ngurta të Rikuperuara) në industrinë e çimentos;
- Përmirësimin e kornizës ligjore për bashkëpërpunimin e mbetjeve si lëndë djegëse alternative në nivel lokal dhe kombëtar duke krijuar një dialog të hapur dhe marrëdhënie besimi me palët e interesuara;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet e mbetjeve si lëndë djegëse alternative;
- Analizën e krijimit dhe shfrytëzimit të rrjetit të grumbullimit për rryma të ndryshme mbetjesh.

Gjithashtu, përgjatë projektit u hartuan dhe një numër dokumentash me rëndësi, ku veçojmë:

- Studimin e Tregut mbi Cilësinë dhe Sasinë e Mbetjeve si edhe Potencialet për mundësinë e prodhimit të Lëndëve Djegëse të Refuzuara në Republikën e Shqipërisë
- Letrën e Pozicionimit për Përmirësimi e Kornizës Ligjore për Bashkë-përpunimin e Mbetjeve si Lëndë Djegëse Alternative në nivel lokal dhe kombëtar në Republikën e Shqipërisë
- Analizën e Nevojave dhe infrastrukturës së Mbetjeve Lokale në lidhje me bashkë-përpunimin e mbejeteve bashkiake
- Studimin e Fizibiliteti për Prodhim të Lëndëve Djegëse Alternative në Landfillin e Bushatit, Shqipëri



waste 2 energy

FEASIBILITY STUDY STUDY FOR THE PRODUCTION OF
ALTERNATIVE FUEL AT BUSHATI LANDFILL, ALBANIA

**SI MUND TË
PËRDOREN MBETJET
PËR PRODHIMIN E
LËNDËVE DJEGËSE
ALTERNATIVE?**



“Investimet në mjedis, investime strategjike për ekonominë, mirëqënien dhe të ardhmen e qëndrueshme” - Konferencë studentore

Me rastin e ‘Ditës së Tokës’, u organizua konferenca studentore me temë “Investimet në mjedis, investime strategjike për ekonominë, mirëqënien dhe të ardhmen e qëndrueshme”. Ky aktivitet bëri bashkë institucione arsimore publike dhe private nga Universiteti Polis (Tiranë), Universiteti i Prizrenit ‘Ukshin Hoti’, dhe Universiteti ‘Aleksandër Xhuvani’ (Elbasan). Përgjatë konferencës u diskutua mbi potencialin e lëndëve djegëse alternative në industrinë e çimentos si dhe përfshirja e mundshme e universiteteve në studime për zbatimin në vendin tonë.

Partneritete lokale për rishikimin e Planeve Lokale të Menaxhimit të Mbjetëve Urbane

Përgjatë muajve Qershor-Gusht 2022, u punua me Bashkitë Mat, Kurbin, Shkodër, Krujë, Durrës dhe Kukës për plotësimin me të dhëna dhe sipas rastit me rishikimin e Planeve Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane. Përmes punës së projektit u mundësua përfshirja në një pjesë të ketyre planeve të konceptit të lëndëve djegëse alternative, procesit të bashkë-përpunimit të mbetjeve si dhe përfitimeve e mundshme financiare dhe mjedisore të tyre.

Përfshirja e bashkive në proces dhe ndryshimet e sugjeruara janë zyrtarizuar me Marrëveshje. Në bashkinë Mat u realizua edhe prezantimi i ndryshimeve të bëra para Këshillit të Bashkisë, i cili ka miratuar ndryshimet përkatëse.

Takime me Organizatat e Shoqërisë Civile, Median dhe Komunitetin

Organizata të Shoqërisë Civile të angazhuara në çështje mjedisore dhe të menaxhimit të mbetjeve u njohën me objektivat dhe gjetjet e projektit

të bazuara në Studimin e Tregut si dhe u njohën me teknologji të reja të cilat ndikojnë në uljen e emetimeve të gazrave të efektit serë, reduktimin e sasive të mbetjeve të depozituara në landfille si dhe reduktimin e sasive të lëndëve djegëse fosile të përdorura në industri.

Takime konsultuese u zhvilluan dhe me gazetarë dhe përfaqësues të mediave lokale, si dhe me komunitete lokale nga zona e Thumanës. Në këto takime u prezantua informacion në lidhje me lëndë djegëse alternative RDF dhe SRF. U pasqyrua skematikisht procesi në të cilin mbetjet e refuzuara kalojnë në prodhimin e lëndës djegëse alternative sipas cilësive përkatëse dhe mënyrat e përdorimit të këtij karburanti në procesin e djegies në industrinë e çimentos.

Takimi i 3-të i Grupit Kombëtar të Punës dhe Prezantimi i Rezultateve Finale të Projektit

Takimi përmbyllës i projektit “Nga Mbetje në Energji për Industrinë e Çimentos në Ballkanin Perëndimor” u zhvillua në muajin dhjetor, pranë zyrave të GIZ Shqipëri. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Agjensisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ GmbH, përfaqësues të bashkive të angazhuara në këtë studim, përfaqësues të shoqërisë menaxhuese të landifillit të Bushatit, përfaqësues të TITAN Antea Cement sh.a, Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar (AMU) dhe përfaqësues të orgnizatave të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, etj.

Temat kryesore të diskutimit përgjatë këtij takimi përfundimtar ishin gjetjet nga Studimit i Tregut, potenciali i prodhimit të lëndëve djegëse alternative RDF/SRF në zonën e studimit, legjislacioni në fuqi dhe përafërimi me atë të BE-së, propozime për plotësimin e kuadrit ligjor të nevojshëm, gjetje nga studimi i fizibilitetit (Teknikat më të mira të mundshme BAT dhe analiza kosto-përfitim), perceptimi i komunitetit në lidhje me lëndët djegëse alternative dhe përdorimi i tyre në fabrikat e çimentos.

Përmirësimi i infrastrukturës
për këmbësorët dhe biçikletat në fshatin Ishull Lehtë,
mbështetur nga Qeveria Zvicerane dhe Austriake

Dhjetor 2022

Projekt nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun Svizra

Agenzia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Austrian
Development
Agency

RDPA

Programi i Zhvillimit Rajonal Albania IV

Periudha e Implementimit: April 2019 - April 2023

Donator: Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC)

Fondi: 7.575.000,00 CHF

Zbatuar nga: ECORYS NL dhe Co-PLAN, Institute for Habitat Development

Zbatuar në: Shqipëri

Programi i Zhvillimit Rajonal Albania IV (RDPA) është një projekt dhe një përpjekje e përbashkët e vazhdueshme për të mbështetur reformën e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), zbatuar në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Qëllimi kryesor i programit RDPA -së është të reduktojë pabarazitë në Shqipëri duke mbështetur zhvillimin e rajoneve të forta, në mënyrë që ato të avancojnë potencialet e tyre dhe të ofrojnë kushte më të mira sociale dhe ekonomike për qytetarët e tyre. Duke qenë se një politikë rajonale efektive për Shqipërinë është jetike, si për të trajtuar pabarazitë historike rajonale, ashtu edhe për t'iu përgjigjur sfidave të ekonomisë moderne të dijes, faza IV-rt e RDPA -së vazhdon të mbështesë Qeverinë Shqiptare në krijimin dhe zbatimin me sukses të politikave rajonale. Në këtë kontekst, programi synon gjithashtu të rrisë kohezionin rajonal, të reduktojë pabarazitë në përdorimin e burimeve, produktivitetin dhe standardet sociale/mjedisore. Kjo do të rrisë efektivitetin e menaxhimit dhe do të krijojë një shoqëri gjithëpërfshirëse me aftësi më të larta dhe punë më të mira për gratë dhe burrat.

Rezultatet kryesore të pritshme nga faza a IV-rt e RDPA mund të përmbledhen si më poshtë:

1. Pushteti qendror mund të përcaktojë, koordinojë dhe zbatojë me sukses kuadrin institucional dhe ligjor për Zhvillimin Rajonal.
2. Fondi Shqiptar i Zhvillimit si autoriteti menaxhues dhe institucionet dhe organet e tjera kompetente për zhvillimin rajonal, mund të përgatisë dhe miratojë kornizën e programit për përdorimin e ardhshëm të fondeve të BE-së dhe përdorin efektivisht dhe strategjik rritjen e fondeve për zhvillimin e rajoneve nëpërmjet qasjes së partneritetit.
3. Kushtet socio-ekonomike për qytetarët shqiptarë përmirësohen nëpërmjet zbatimit të projekteve të zhvillimit rajonal që pasqyrojnë nevojat dhe prioritetet rajonale.

**SI MUND TË NXITET
BASHKËPUNIMI
MIDIS SEKTORËVE
PUBLIK, PRIVAT DHE
JO-FITIMPRURËS PËR
ZHVILLIMIN RAJONAL
TË QËNDRUESHËM?**



Ngritja e Kapaciteteve për Pushtetin Vendor – një grup i vazhdueshëm trajnimesh

Përgjatë vitit 2022, u realizuan me sukses dy trajnime me temën “Analiza e fizibilitetit dhe kosto-përfitimit” dhe “Udhëzuesi praktik për procedurat e prokurimit, dhënien e granteve dhe kontratave për veprim të jashtëm të Bashkimit Evropian (PRAG)” në 4 Rajonet e vendit, me pjesëmarrjen e stafit teknik nga 61 Bashki. Për të mbështetur në mënyrë më efektive njohuritë brenda institucioneve dhe palëve të interesuara të Shqipërisë, të dyja kurrikulat e trajnimit u dorëzuan në mënyrë specifike në një seminar të Trajnimit të Trajnerëve. Trajnimet u realizuan në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit Rural dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike-ASPA (2021) për trajnimin e institucioneve të qeverisjes vendore me fokus kryesisht në forcimin e stafit teknik të drejtorive bashkiake të cilat merren drejtpërdrejt me përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm.

Gjatë periudhës prill – shtator 2022, u finalizua me sukses Asistenca Teknike për Qeverinë Shqiptare në Kapitullin 22 - “Politika Rajonale dhe Koordinimi i instrumenteve strukturore” është një nga kapitujt kryesorë të Acquis. Kapitulli bëhet edhe më i rëndësishëm duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare (të ardhshme) do duhet të kenë një kornizë institucionale dhe kapacitete të përshtatshme administrative për të siguruar programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin në një mënyrë të shëndoshë dhe me kosto efektive nga pikëpamja e menaxhimit dhe e menaxhimit dhe kontrollin financiar.

Zëvendësministri i Brendshëm në Shqipëri është caktuar si koordinator kombëtar për Kapitullin 22 dhe Agjencia për Mbështetjen e Pushtetit Vendor (ASLG) është kërkuar të luajë rolin e sekretariatit teknik në këtë proces. Ndërkohë, duke qenë se Qeveria e Shqipërisë po mbështetet nga qeveritë





zvicrane dhe austriake, nëpërmjet Programit të Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (RDPA) – dhe për shkak se një nga objektivat kryesore të RDPA është të mbështesë një reformë në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së dhe Politikën e Kohëzimit të BE-së – Zëvendësministri i Brendshëm dhe drejtori i ASLG-së kërkuar mbështetjen e AZHR-së për procesin e punës përgatitore për Kapitullin 22.

Skema e Granteve të RDPA – Aktivitetet e Inagurimit

Më 15 korrik 2021 RDPA nisi Skemën e Dytë të Granteve që synon të gjitha bashkitë e vendit. Skema e Granteve u përgatit në përputhje me “Programin për Zhvillimin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të 100+ Fshatrave të Shqipërisë 2022-2026” zbatuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pasi objektivat e programit “100 fshatrat” kontribuojnë në objektivat e RDPA. Objekti dhe natyra e Skemës së dytë të Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohëzimin u fokusua në dimensionet e zhvillimit rajonal dhe inkurajimin e institucioneve dhe partnerëve për të bashkëpunuar përmes projekteve ndërkomunale dhe/ose projekteve me një ndikim të qartë të zhvillimit rajonal. Skema e Granteve akordoi 10 projekte nga 10 Bashki (Belsh, Kolonjë, Gjirokastrë, Berat, Malësi i Madhe, Selenicë, Dibër, Librazhd, Kukës, Lezhë), me një shumë totale grante prej 158,092,012 lekë. Pas zbatimit të projekteve të mbështetura, gjatë muajve korrik – dhjetor 2022, në sheshet e secilës bashke u zhvilluan një sërë aktivitetesh inauguruese, me pjesëmarrjen e Ambasadorit të Zvicrës dhe Ambasadorit të Austrisë, kryetarëve të bashkive, FSHZH-së, stafit të projektit dhe qytetarëve.

The image shows the bottom corners of two flags. On the left is the European Union flag, featuring a blue field with twelve yellow stars arranged in a circle. On the right is the Albanian flag, featuring a red field with a black double-headed eagle. The flags are set against a dark wood-grain background.

ideAL

Dialog për Zhvillimin e Politikave Gjithëpërfshirëse
të Bazuar në Dëshmi në Shqipëri

Periudha e Zbatimit: 01/06/2020 - 07/06/2023

Donator: Bashkimi Evropian

Fondi: 1,000,000 EUR

Zbatuar nga: Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe Qendra e Politikave Evropiane (EPC)

Zbatuar në: Shqipëri

Projekti **“Dialog për zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse të bazuar në evidencë në Shqipëri”** (i referuar si **IdeAL**) përfundoi me sukses vitin e tretë të zbatimit. Objektivi i përgjithshëm i IdeAL është të kontribuojë në përmirësimin e dialogut të politikave publike në Shqipëri duke forcuar dialogun e politikave në proceset e reformës dhe duke lehtësuar angazhimin dhe dialogun ndërmjet institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore dhe aktorëve joshetërorë. Në terma më specifikë, projekti synon (i) Të lehtësojë ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe aktorëve joshetërorë (shoqëria civile, grupe kërkimore, partnerë socialë, media, studiues, etj.) dhe të mbështesë dialogun e politikave të strukturuar dhe të bazuar në fakte. në proceset reformuese; (ii) Të krijojë një platformë për zhvillimin e kapaciteteve për të mbështetur aktorët joshetërorë në fushat që lidhen me formulimin e politikave publike, buxhetimin e politikave, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin; (iii) Të krijojë një platformë komunikimi dhe mësimi mbi dialogun e politikave, për të nxitur përpjekjet për politikëbërje, për të promovuar rezultatet, praktikën e mira, mësimet e nxjerra dhe përmirësimet e vazhdueshme. Një element i rëndësishëm i projektit është ai i ofrimit të mbështetjes teknike dhe financiare për aktorët vendas joshetërorë – përfshirë individë apo organizata. Kjo mbështetje përbënte një pjesë thelbësore të ngritjes së kapaciteteve dhe sigurimit të shkëmbimit dhe rrjetëzimit të njohurive ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Disa nga arritjet kryesore të projektit në këto tre vjet mund të përmbledhen si më poshtë:

- Të paktën 21 iniciativa me ndikim në politika u identifikuan dhe u mbështetën në procesin e shtyrjes përpara propozimeve kuptimplota që synojnë prezantimin e ndryshimeve ose përmirësimeve të politikave në një spektër temash që prekin aspekte të ndryshme të realitetit tonë lokal dhe pamjen më të gjerë të politikëbërjes në një nivel qendror.
- Në shumë raste, propozime të tilla janë miratuar nga institucionet përkatëse siç ishte rasti në një sërë sektorësh, ku përfshijmë:

- ‘Propozime mbi Protokollet e Menaxhimit të Sëmundjeve Kronike në kohë emergjencash’ të paraqitura nga Together for Life;
 - Propozime për një sërë aspektesh brenda sektorëve të turizmit, duke përfshirë: Masat për të frenuar informalitetin midis komunitetit të guidave turistike; Propozimet për përfshirjen e DMO-ve dhe dispozitave përkatëse në Ligjin aktual për Turizmin; propozimet për futjen e standardeve të certifikuara në sektorin e hotelierisë në Shqipëri; etj.
 - Propozim për parandalimin e djegies së tokës bujqësore - përmirësime të legjislacionit aktual që rezulton me një ligj të ndryshuar, siç është propozuar nga Shoqata Iliria, aktualisht në pritje të miratimit në Kuvend; etj.
 - Propozim për uljen e moshës së pensionit të një grupi të caktuar shoqëror të komunitetit rom që përfiton pension social, i propozuar nga Qendra T’Reja në bashkëpunim me dy organizata të tjera vendore;
- Dialogë të shumtë (të paktën 42) janë iniciuar dhe avancuar në nivel lokal ose kombëtar, në formën e tryezave të rrumbullakëta, tryezave të diskutimit, forumeve kombëtare, etj.;
 - U ofruan disa mundësi shkëmbimi për organizatat dhe individët më të angazhuar nën-grantmarrëse, duke arritur në mbi 50% të organizatave dhe individëve nën-grantmarrës të mbështetur. Vizita të tilla shkëmbimi ishin në formën e shkëmbimeve të strukturuar dhe mundësive të dialogut me politikëbërësit e nivelit të BE-së, në Bruksel, apo vende të tjera anëtare me interes, në varësi të fokusit të iniciativës së organizatave ose individëve të veçantë;
 - Janë organizuar disa sesione trajnimi nga profesionistë me përvojë në çështjet e ndikimit në politika, avokimit, komunikimit për ndikim, ndikimit në politika dhe etikës, etj.;
 - U zhvillua një koleksion solid burimesh, qofshin ato në formën e manualeve, klipeve të studimit të rasteve ose dokumenteve të politikave të cilat janë shpërndarë përmes platformës së dedikuar www.ide-al.org.
 - Në funksion të një tradite të gjatë, Co-PLAN ka vazhduar të ofrojë kontributin e tij me shkrim në procesin e hartimit të raportit të progresit të vendit të BE-së për Shqipërinë. Në mënyrë të ngjashme, ajo ka inkurajuar komunitetin e organizatave dhe individëve që mbështeti, për të adoptuar praktika të ngjashme duke dhënë kontribut, veçanërisht kur kërkohet në mënyrë specifike nga autoritetet.



**SI MUND TË
FAKTORIZOHET ROLI
DHE KONTRIBUTI
PËRMBAJTËSOR I
SHOQËRISË CIVILE
NË POLITIKËBËRJE?**

Advokim dhe ndërgjegjësim për ndryshimet klimatike dhe një marrëveshje e gjelbër për Shqipërinë - Forum Kombëtar

Një nga organizatat e mbështetura përmes projektit “Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri-ideAL”, ishte Instituti i Politikave Mjedisore me projektin ‘Avokim dhe ndërgjegjësim për ndryshimet klimatike dhe një marrëveshje e gjelbër për Shqipërinë’. Si pjesë aktiviteve të parashikuara, Instituti i Politikave Mjedisore prezantoi gjetjet në një forum kombëtar me pjesëmarrjen e vendim-marrësve në nivel qendror, lokal si dhe pjesëmarrës të shoqërisë civile. Gjetjet evidentuan një konflikt kompetencash midis institucioneve vendore dhe atyre qendrore për marrjen e masave ndaj ndryshimeve klimatike nga njëra anë dhe një mungesë e zbatueshmërisë së dokumentave strategjikë kombëtarë për ndryshimet klimatike nga ana tjetër që njëkohësisht janë edhe barrierë frenuese ndaj integritetit të Shqipërisë në BE. Pavarësisht sfidave në nivel qeverisje, komuniteti dhe bizneset u shprehën të gatshme për të kontribuar - palë interesi edhe më të ekspozuara ndaj ndryshimeve klimatike.

Reforma e Administratës Publike: Si të rritet efikasiteti i reformës strukturore - Forum Kombëtar

Co-PLAN, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Publike dhe Ligjore zhvilluan Forumin Kombëtar: “Reforma e Administratës Publike: Si të rritet efikasiteti i reformës strukturore”.


Në qendër të diskutimit ishte vlerësimi i ecurisë së reformës strukturore në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dy subjekte studimi në kuadër të nismës së #ISPL mbështetur nga #ideAL.

Përgjatë tij u prezantuan gjetjet e këtij raporti studimor, të ndërmarra gjatë vitit 2021 si dhe u fol për propozimet dhe sugjerimet tjera të mundshme mbi efikasitetin e kësaj reforme.

Të pranishëm në këtë aktiviteti ishin znj. Albana Koçi, përfaqësuese e Departamentit të Administratës Publike, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, ekspertë të fushës dhe grupe të tjera interesi.

Reforma strukturore, e filluar në vitin 2017 synon forcimin e funksionit të politikëbërjes në ministrinë e linjës, i cili u riorganizua në tre drejtori: zhvillimi i politikave, zhvillimi i programeve dhe konceptualizimi/ fizibiliteti i projekteve.

Projekti “Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri-ideAL” zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe Qendra e Politikave Evropiane (EPC, Belgjikë) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



FINANCATVENDORE.AL

Financat Publike Vendore

Periudha e Implementimit: 01/07/2019 – 30/06/2023

Donator: Mbështetur nga LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

Fondi: 7.575.000,00 CHF

Zbatuar nga: Co-PLAN, Institute for Habitat Development


Zbatuar në: Shqipëri

Objektivi kryesor i projektit është të sigurojë një pasqyrë të plotë të financave publike vendore të 61 bashkive në Shqipëri në mënyrë periodike, të strukturuar dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht. Platforma e financave vendore **www.financatvendore.al** ofron të dhëna të detajuara (sipas zërave dhe në nivel bashkie), duke siguruar një seri kohore për financat vendore që nga viti 2010. Raportet analitike tremujore dhe artikujt tematikë informojnë mbi zhvillimet në të ardhurat dhe shpenzimet, arritjet dhe sfidat me të cilat përballen bashkitë në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara nga kuadri rregullator në fuqi.

Objektiva specifike:

- Të ofrojë një burim informacioni të besueshëm, metodologjikisht të shëndoshë, për të gjitha palët e interesuara, përfshirë bashkitë, OSHC-të, qytetarët, akademinë, ekspertët, mediat, etj., në funksion të planifikimit më të mirë të përdorimit të burimeve financiare dhe mundësimin të hulumtimeve të detajuara për çështjet e qeverisjes vendore.
- T'u mundësojë zgjedhësve vendorë një instrument për të ndikuar në vendimet e bashkive mbi mënyrën si përdoren paratë publike përkundrejt prioriteteve të komunitetit.
- Të vlerësojë perceptimin e qytetarëve për taskimin vendor, çfarë ndikon në vendimin për të paguar ose jo taksat, perceptimin mbi shërbimet vendore të ofruara dhe gatishmërinë për të paguar për shërbime të përmirësuara. Njohja me perceptimin e qytetarëve mbi taksimin dhe shërbimet publike vendore, faktorët ndikues dhe sfida për të rritur pagueshmërinë e taksave vendore, mundësojnë përmirësimin e sistemit nga këndvështrimi qytetar.

**FINANCAT PUBLIKE
VENDORE - SI ISHTE
PERFORMANCA E
BASHKIVE NË VEND
GJATË VITIT 2022?**



FINANCATVENDORE.AL

+50 TREMUJORË TË DHËNASH PËR 61 BASHKI
(PREJ VITIT 2010)

+30 RAPORT TË FINANCIVE PUBLIKE VENDORE

61 PROFILE BASHKISH

21,157 PËRDORUES (JANAR 2023)

177,773 FAQE TË PARA (JANAR 2023)



GreenFORCE

Nxitja e Ekselencës në kërkimin Shkencor për
Tranzicionin e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor

Periudha e Implementimit: 1 Korrik 2022 – 30 Qershor 2025

Donator: Agjencia Ekzekutive Evropiane e Kërkimit (REA)

Fondi: 1 499 305.00 EUR

Zbatuar nga: Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, University of Belgrade – Faculty of Geography (UB-GEF) , Center for Economic Analysis Association (CEA) Nordregio, Politecnico di Torino (POLITO), Universiteti POLIS

Zbatuar në: Ballkanin Perëndimor

GreenFORCE - Nxitja e Ekselencës në kërkimin Shkencor për Tranzicionin e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor është një projekt Horizon, i financuar nga Agjencia Ekzekutive Evropiane e Kërkimit (EREA), që filloi zbatimin në Korrik 2022.

Partneri koordinues i projektit është Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në Shqipëri dhe dy partnerët rajonalë janë University of Belgrade – Faculty of Geography (UB-GEF) në Serbi dhe Center for Economic Analysis Association (CEA) në Maqedoninë e Veriut. Nordregio, një organizatë kërkimore mbarë-nordike e cila ndodhet në Suedi, së bashku me Politecnico di Torino (POLITO), Itali janë institucionet kryesore kërkimore të BE-së, ndërsa Universiteti POLIS në Shqipëri është partneri i asociuar i Co-PLAN.

GreenFORCE synon të nxisë përsosmërinë në kërkimin shkencor dhe inovacionin e Co-PLAN, CEA dhe UB-GEF, përgjatë Tranzicionit të Gjelbër të Ballkanit Perëndimor, si një mjet për të përmirësuar profilin e tyre kërkimor, duke forcuar kapacitetet kërkimore dhe menaxhuese të stafit të tyre dhe duke kontribuar në konvergjencën midis kapaciteteve kërkimore të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, si dhe në nisma më të gjera të politikave për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ambicia e këtij projekti është të mundësoj kapërcimin nga të mësuarit individual në të mësuarit institucional, duke siguruar që praktikën e kërkimit dhe të menaxhimit të institucionalizohen brenda organizatave marrëse. GreenFORCE do të kontribuojë në “Përmirësimin e aksesit në përsosmëri” duke mundësuar rrugë bashkëpunimi, shkëmbimi, bashkë-projektimi, bashkëkrijimi me akademinë, shoqërinë civile dhe politikëbërësit në nivel rajonal.

**SI TË NXISIM
PËRSOSMËRINË NË
KËRKIMIN SHKENCOR
PËR TRAZICIONIN
E GJELBËR NË
BALLKANIN
PERËNDIMOR?**

Kick-Off i projektit GreenFORCE

Më 4 Korrik 2022, partnerët e projektit nisën zyrtarisht projektin GreenFORCE me një event virtual që mbledhi të gjithë partnerët dhe synoj të inicioj projektin.

Ngjarja shërbeu për të miratuar marrëveshjen e konsorciumit, për të përcaktuar përgjegjësitë etike dhe të IPR, për të diskutuar dhe rënë dakord mbi qasjen e projektit, aktivitetet dhe detyrat për secilën nga paketat e punës, përgatitjen e rezultateve të projektit dhe koordinimin ndërmjet partnerëve të projektit.

Përgatitja e Planit të Publikimit të Kërkimeve Shkencore dhe Agjendës së Përbashkët Strategjike të Kërkimit

Objektivi i Planit të Publikimit të Kërkimeve Shkencore është të organizoj dhe monitoroj prodhimin shkencor i krijuar nga projekti duke siguruar arritjet e identifikuar në propozim.

Agjenda e Përbashkët Strategjike e Kërkimit është një agjendë e përbashkët kërkimore afatgjatë për organizatat e binjakëzimit me fokus të veçantë në monitorimin dhe planifikimin e tranzicioneve të qëndrueshme në nivele territoriale lokale në Ballkanin Perëndimor.

Këto janë dy dokumente thelbësore të projektit të cilat janë në përgatitje e sipër, përmes punës bashkë-dizenjimit, diskutimeve dhe seminareve si dhe përfshirjes së të gjithë partnerëve. Deri më tani janë zhvilluar dy punëtori në format hibrid për të çuar më tej punën mbi këto dokumente.

Punëtorja e Bashkë-Dizenjimit që kontribuon në Konceptualizimin e Tranzicionit të Gjelbër të Drejtë në Ballkanin Perëndimor

Studimi i efekteve dhe kostove të tranzicionit të gjelbër në Ballkanin Perëndimor është një nga qëllimet kryesore të projektit GreenFORCE. Në këtë kuadër, u organizuan dy punëtori të bashkë-dizenjimit më 8 dhe 22 Nëntor, 2022 për të hetuar gatishmërinë/potencialin e aktorëve shoqërorë përgjatë procesit të tranzicionit të gjelbër dhe për të ofruar një kornizë për monitorimin e vazhdueshëm të ndikimeve dhe kostove.



Objektivi kryesor i punës bashkë-dizenjimit ishte të mbështeste konceptualizimin e Tranzicionit të Gjelbër në Ballkanin Perëndimor, nga pikëpamja politike, socio-ekonomike, hapësinore, shkencore dhe teknologjike.

Punëtorja e parë e bashkë-dizenjimit ofroi informacion dhe ekspertizë rreth kontekstit, vështirësive dhe mënyrës sesi palët e interesuar rajonal trajtojnë çështjet që lidhen me fatin e politikave të lidhura me tranzicionin e gjelbër në Ballkanin Perëndimor.

Qëllimi i punës bashkë-dizenjimit ishte të stimulonte dialogun mbi hulumtimin e tranzicionit të gjelbër duke përdorur tre raste studimore nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria si pikënisje.

Gjetjet kryesore nga këto punëtori kontribuon në krijimin e dokumentit 'Konceptualizimi i Tranzicionit të Gjelbër në Ballkanin Perëndimor' (D4.1), i cili ofron një pasqyrë të mënyrës sesi konceptohet Tranzicioni i Gjelbër në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në lidhje me fazën përgatitore, rolin e aktorëve të ndryshëm shoqërorë, bashkëpunimi i tyre për të arritur ambiciet dhe në fund ndikimet (kostot dhe përfitimet) që mund të ketë tranzicioni në shoqëri.

Dy punëtori të tjera bashkë-dizenjimi do të mbahen, të cilat do fokusohen në diskutimin e një kuadri për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të ndikimeve të tranzicionit të gjelbër në Ballkanin Perëndimor, dhe priten të organizohen gjatë vitit 2024.







SAIL

Nxitja e Nismave të Aktivizmit në Nivel Lokal

Periudha e Implementimit: 07/2020 - 12/2021

Donator: Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, Ambasada Amerikane në Tiranë

Fondi: 180,000 USD

Zbatuar nga: Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Zbatuar në: Shqipëri

SAIL ndërton në traditën e projektit ‘Kindle Advocacy’ (2016) dhe mbështet aktivistët e rinj dhe organizatat e shoqërisë civile të luajnë rol më aktiv në procese kyçe të ngritjes, apo ndikimit në çështje urgjente që lidhen me qeverisjen, demokracinë, ndërtimin e qytetit, të drejtat dhe çështje të ngjashme që formësojnë dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve në zonat urbane dhe rurale.

Projekti synon të:

1. Forcimi i kapaciteteve të brendshme të OSHC-ve lokale dhe aktivistëve të rinj për të monitoruar, analizon dhe ndërmerr hapa/veprime konkrete në lidhje me politikëbërjen në fushat e politikave që lidhen me qeverisjen, demokracinë, ndërtimin e qytetit, të drejtat, etj.
2. Promovimi dhe përhapja e kulturës së aktivizmit dhe avokimit duke lehtësuar ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërmjet aktivistëve, organizatave të shoqërisë civile, mediave, studiuesve, etj.) dhe mbështet dialogun e politikave të strukturuar dhe të bazuar në dëshmi në çështjet urgjente dhe proceset e rëndësishme të demokracisë dhe qeverisjes.

Projekti synon të kultivojë dhe të rrisë kapacitetet e brendshme të organizatave të shoqërisë civile lokale dhe aktivistëve të rinj për të monitoruar, analizuar dhe ndërmarrë hapa/veprime konkrete përmes një programi të dedikuar për aftësimin e tyre të njohur si #shkëndija. Pjesëmarrësve në program u ofrohen mundësi për zhvillimin e kapaciteteve dhe përvojën e advokimit. Ekipi i përkushtuar i mentorëve, mbështet çdo pjesëmarrës në programin #shkëndija të ndërmarrë një sërë hapash konkretë për realizimin e nismës së tyre.

**SI MUND TË RRITET
ANGAZHIMI QYTETAR
NË NIVEL VENDOR?**



Programi #shkëndija 2022


Gjithsej, pesëmbëdhjetë (15) aktivistë dhe/ose grupe në dymbëdhjetë (12) qytete të ndryshme të vendit kanë përfunduar me sukses programin #shkëndija, duke arritur ndryshime konkrete.


Disa nga nismat kanë hartuar dhe publikuar produkte specifike advokimi; si sdokumente politikash, artikuj dhe fushata.

Rreth njëzet (20) aktivitete janë organizuar nga aktivistët lokalë, duke përdorur njohuritë e fituara përgjatë programit, të frymëzuar nga procesi i trajnimit dhe gjithashtu të mbështetur nga mentorët.

Me mbështetjen e SAIL 2, pjesëmarrësit kanë mundur të kenë akses në median kombëtare dhe të ekspozojnë nismat e tyre; disa prej tyre janë ftuar në emisione të njohura televizive të mëngjesit (nismat nga CYC Gjirokastra, Sashen Rexhepaj, Antigoni Bullari), ndërsa pothuajse të gjithë nismat janë dokumentuar në formën e videove prezantuese të shkurtra për punën dhe arritjet e tyre. Gjithashtu, #shkëndijat janë promovuar vazhdimisht në kanale zyrtare të mediave sociale dhe faqes zyrtare të mediave sociale të Co-PLAN.

Në vitin 2022, u shënua edhe përvjetori i 5-të i Ditës Kombëtare të Aktivizmit (#NAD), një traditë e arritur e festuar “me veprime konkrete” në të gjithë vendin. Mbi njëzet (20) organizata dhe aktivistë kanë marrë pjesë në NAD 2022. Një pjesë e këtyre organizatave morën pjesë në aktivitete aktivizmi të shumta e të natyrave të ndryshme në fshatin Ferraj, jashtë Tiranës, ndërsa aktivistë dhe organizata në vende të ndryshme të vendit organizuan aktivitete dhe i pasqyruan ato online për t'i bashkuar programit të NAD2022.







Green -AL

Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile
për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri

PROJEKTIT GREEN
VILE PËR MBRO

Periudha e Implementimit: 1/01/2021 - 31/12/2023

Donator: Agjencia Qeveritare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).

Fondi: 1.223.100 EUR

Zbatuar nga: Co-PLAN, Institute for Habitat Development, CISP , Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario VIS Albania, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo

Zbatuar në: Shqipëri


Green-AL “Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri” financohet nga Agjencia Qeveritare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA) dhe zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit si partner drejtues, në bashkëpunim me organizatat CISP Sviluppo dei Popoli, VIS Albania, dhe COSV – Cooperazione per lo Sviluppo.

Ky projekt synon të kontribuojë në përmirësimin dhe fuqizimin e organizatave mjedisore dhe të ndikojë në nxitjen e bashkëpunimit midis aktorëve të shoqërisë civile, autoriteteve publike dhe sektorit privat për të advokuar dhe adresuar çështjet mjedisore në Shqipëri.

Green-AL adreson edhe sfidat e kufizimet e OSHC-ve mjedisore lokale lidhur me përmirësimin e qëndrueshmërisë organizative dhe profesionalizmit të tyre, rritjen e shkallës së përthithjes dhe menaxhimit të granteve nga donatorët e huaj, përmirësimin e aftësive për t'u angazhuar në partneritete efektive dhe angazhimin e tyre në lobim dhe advokim në mënyrë që të ndikojë në vendimmarrje brenda sferës mjedisore. Projekti Green-AL do të adresojë këto nevoja përmes:

- (a) Ngritjes së kapaciteteve të OSHC-ve për t'i bërë ato më profesionale dhe më të qëndrueshme;
- (b) Dhënies dhe zbatimit të granteve;
- (c) Aktiviteteve për advokim dhe përgatitjen e dokumenteve të politikave, pjesëmarrjen në tryeza të rrumbullakëta dhe seminare për të ndikuar në politikëbërjen;
- (d) Një sërë aktiviteteve për të nxitur bashkëpunimin dhe rritur ndërgjegjësimin përmes produkteve multimediale (dokumentarë, klipeve dhe infografikave), publikime, ngjarje publike, etj.

**SI MUND TË RRITET
NDIKIMI I
ORGANIZATAVE
NË PROCESE
POLITIKËBËRJE NE
FUSHËN E MJEDISIT?**



Perspektiva gjinore në Organizatat e Shoqërisë Civile

Ekipi i Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me ekspertin Rudina Pasholli, organizoi dy sesione trajnimi në qytetin e Kukësit, në datat 12 dhe 14 Dhjetor 2022, me tematikë “Perspektiva gjinore në Organizatat e Shoqërisë Civile”, si pjesë e procesit të inkubimit të projektit #GreenAL. Trajnimi në fjalë u realizua për të gjitha organizatat e shoqërisë civile të cilat operojnë në rajonin veri-lindor, si dhe individë e profesionistë të lirë.

Në fokus të trajnimit ishte njohja me konceptet bazë të barazisë gjinore në lidhje me mjedisin, mënyrat e përfshirjes së elementit gjinor në projekte, si edhe rolet dhe dinamikat gjinore. Nëpërmjet një procesi ndërveprimi dhe ushtrimesh praktike, pjesëmarrësit diskutuan dhe shkëmbyen mendime dhe pikëpamje mbi barazinë gjinore.

Mbështetje tematike dhe financiare e organizatave të shoqërisë civile përmes skemës së granteve

Përgjatë vitit 2022, një total prej 31 projektsh u përzgjedhën për mbështetje financiare përmes dy thirrjesh për projekt propozimesh me fokus në iniciativa dhe partneritete si dhe rrjetëzim, advokim dhe ndikim në politikëbërje. Mbi 60 organizata përfituan nga mbështetja që do të ofrohet përmes trajnimeve aftësuese dhe mbështetjes financiare.







WBC-RRI.NET

Zhvillimi i Kërkimit dhe Inovacionit të Përgjegjshëm në
vendet e Ballkanit Perëndimor: Përmirësim i ekosistemeve të
Vetë-Qëndrueshme të Kërkimit e Inovacionit

Periudha e Implementimit: Mars 2021 - Mars 2024

Donator: Bashkimi Europia, H2020-SwafS

Fondi: 197,000 EUR

Zbatuar nga: University of Novi Sad (Lead Partner); University of Banja Luka; Co-PLAN, Institute for Habitat Development; Vojvodina ICT Cluster; South-East European Research Centre; Zentrum für Soziale Innovation; Macedonian Academy of Sciences and Arts; NCDIEL; European Science Foundation; Ministry of Tourism and Environment, Albania; The Association “Knowledge, Education and Science – ZONA”; Science Technology Park Montenegro; RTD HEALTH CLUSTER.

Zbatuar në: Kune-Vain-Tale Lagoon; Country of Montenegro; Autonomous Province of Vojvodina; Republic of Srpska; City of Skopje.

Qëllimi i përgjithshëm i **WBC-RRI.NET** është të nxisë zbatimin e parimeve të Kërkimit dhe Inovacionit të Përgjegjshëm (RRI) në nivel territorial në Vendet e Ballkanit Perëndimor (WBCs), në mënyrë që të promovojë krijimin e një kornize qeverisëse orientuese për R&I (Kërkimin dhe Inovacionin), e aplikueshme në shumë nivele. Qasja bazohet në arsyetimin se koncepti i RRI, i përshtatur kryesisht në nivelin e institucioneve kërkimore, mund të zbatohet edhe në nivelin e qeverisjes rajonale dhe territoriale të kërkimit dhe inovacionit. Qasja e projektit trajton pesë territore të ndryshme të Ballkanit Perëndimor (4 ekosisteme në nivel rajoni dhe 1 ekosisteme në nivel vendi) dhe do të aktivizojë përfshirjen e RRI në to. Në shkallën makro, një sërë aktivitete të RRI-së janë duke u zbatuar gjatë gjithë projektit, duke ngritur një dialog aktiv në makro-rajonin e WB-së dhe duke nxitur të kuptuarit e të gjitha shtyllave dhe parimeve të RRI-së nën një kuadër holistik. Këto aktivitete shoqërohen me zhvillimin dhe zbatimin e 5 nismave ‘ankor’ të RRI-së. Në Shqipëri, nisma e ‘ankorimit’ “Shkenca qytetare në ekosistemin ligatinor të Lagunës Kune-Vain” targeton dy çelësa kryesorë të RRI, konkretisht Pjesëmarrjen Publike të kombinuar me Qeverisjen, në territorin e Qarkut të Lezhës. Fokusi kryesor i kësaj nisme në Lagunën e Kune-Vain-it janë shërbimet e ekosistemit, duke theksuar nivelin e ulët të njohurive dhe mobilizimit të aktorëve publik dhe jo publik ndaj çështjeve mjedisore dhe mbrojtjes së ekosistemeve të ngjashme.

**CILAT JANË PARIMET
E KËRKIMIT DHE
INOVACIONIT TË
PËRGJEGJSHËM?**



Workshop i parë, bashkë-projektimit në Lagunën Kune-Vain-Tale

Ky workshop i bashkë-projektimit mbledhi së bashku përfaqësues nga aktorë kombëtar dhe lokal, për të diskutuar mbi skenarin e zhvillimit të nismës së ankorimit 'RRI' (Kërkim dhe Inovacion i Përgjegjshëm) në Shqipëri, në Lagunën Kune-Vain-Tale. Nisma e ankorimit synon të zbatojë praktikën e shkencës qytetare në vlerësimin e shërbimeve të ekosistemit të kësaj zone të mbrojtur, në kontekstin e rritjes së cënueshmërisë nga ndryshimet klimatike. Aktiviteti mbledhi 30 aktorë, kryesisht nga qeveria kombëtare, rajonale dhe vendore; gjithashtu, përfaqësues nga institucionet akademike; organizatat e shoqërisë civile; dhe sektorit privat. Objektivat kryesore të këtij workshopi të parë ishin:

- Evidentimi dhe bashkëvlerësimi me aktorët të problemeve dhe sfidave të qëndrueshmërisë së Lagunës;
- Identifikimi i aspekteve e çështjeve kyçe dhe shërbimet e ekosistemit prioritare, për të studiuar në Lagunë;
- Diskutim i hapur për të ardhmen e Lagunës në kuadër të ndryshimeve klimatike;
- Votimi dhe zgjedhja e skenarit më të përshtatshëm për të ardhmen

Workshopi përfundoi me një diskutim të hapur, ku pjesëmarrësit votuan për skenarin më të dëshirueshëm (Skenari 2: Sistemi socio-ekologjik resiliënt) dhe më realist (Skenari 3: Gati për fatkeqësi) për të ardhmen. Me këtë zgjedhje, pjesëmarrësit rikonfirmuan rolin e tyre në të ardhmen si aktor kryesorë në lagunë; dhe angazhimin e tyre për të përdorur dhe menaxhuar lagunën si një burim i përbashkët, kolektivisht dhe në përpunje me parimet etike mjedisore.

Workshopi i dytë i bashkë-projektimit në Lagunën Kune-Vain-Tale

Ky aktivitet u fokusua në bashkëkrijimin e aktiviteteve për vlerësimin e shërbimeve të ekosistemit në lagunë, si pjesë e zbatimit të vizionit të skenarit të së ardhmes për vitin 2024. Aktiviteti mbledhi 33 aktorë nga pushteti vendor dhe rajonal, organizatat e shoqërisë civile të fokusuara në çështjet dhe mbrojtjen mjedisore, institucionet akademike dhe bizneset lokale (peshkatarët dhe pronarët e restoranteve në zonën e mbrojtur) duke diskutuar mbi metodologjinë që do të përdoret për vlerësimin e shërbimeve të ekosistemit, bazuar në gjetjet e workshopit të parë. Qëllimi i seminarit ishte dakordësimi mbi metodologjitë e përgjithshme për vlerësimin e këtyre shërbimeve dhe se si të kanalizohet njohuria e bazuar në të dhëna në politik-bërje. Workshopi u organizua në dy sesione, ku sesioni i parë trajtoi temat që lidhen me 'Krijimin e njohurive mbi vlerat e lagunës dhe vizionimin e së ardhmes', ndërsa sesioni i dytë u fokusua në prezantimin dhe vlefshmërinë e shërbimeve që do të hartëzohen dhe vlerësohen, duke përfshirë dhe metodologjinë përkatëse për t'u aplikuar. Si përfundim, shërbimet e ekosistemit që u identifikuan si më të rëndësishme në kontekstin e lagunës Kune-Vain janë: Sigurimi i peshkimit; Pastrimi i ujit nga kanalet e ujitjes bujqësore dhe ujërat e zeza; Zbutja e përmbajtjeve bregdetare dhe baticave ekstreme; Sekuestrimi i karbonit nga toka dhe bimësia ujore; Shërbime rekreative dhe kulturore.

Pilotimi i shkencës qytetare dhe praktikave të tjera të RRI në Ekosistemet e Shqipërisë, Workshop 3-7 Tetor 2022 në kuadër të Javëve së Arkitekturës në Tiranë, Going High! Të mirat dhe të këqijat e Valorizimit të qytetit

Ky workshop u organizua dhe u moderua nga Dr. Kejt Dhrami dhe MSc. Imeldi Sokoli. Gjithashtu me pjesëmarrjen e Dr. Rudina Toto dhe Dr. Rodion Gjoka si prezantues të ftuar në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe mbështetur nga 10 ekspertë të stafit të Co-PLAN.

Qëllimi i workshopit ishte të pilotonte një proces të shkencave qytetare me studentë të studimeve mjedisore, planifikimit dhe arkitekturës, duke simuluar 2 role në proces. Së pari, ata vepruan si qytetarë të përfshirë në shkencë, duke pilotuar një proces ku prodhuan njohuri shkencore përmes një ushtrimi hartografik. Së dyti, studentët vepruan si ‘shkencëtarë qytetarë’, duke përfshirë komunitetin në procese pjesëmarrëse që synonin prodhimin e njohurive shkencore. Në këtë rast, studentët e drejtuan procesin duke ndjekur parimet e kërkimit të përgjegjshëm.

Qasja e shkencës qytetare promovohet si një kombinim i ‘dimensioneve’ kryesore të kërkimit të përgjegjshëm dhe inovacionit, i njohur ndryshe si RRI, i zbatuar në zonën pilot të Lagunës Kune-Vain në Bashkinë Lezhë, nën ombrellën e projektit Horizon WBC-RRI.NET, zbatuar nga Co-PLAN dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Studentët kontribuan në dy nga komponentët e trajtuar nga projekti, që janë zbutja e përmytjeve në bregdet dhe shërbimet turistike dhe rekreative.

Workshopi kishte 30 pjesëmarrës dhe u organizua në 3 pjesë kryesore: pjesa didaktike/eko-dizajn; pjesa anketuese dhe eksperimentale; dhe pjesa e ekspozimit.

Realizimi i matjeve për Shërbimin e Sekuestrimit të Karbonit në Pyllin e Pishave të Lagunës Kune-Vain

Në kuadër të projektit WBC-RRI.NET u realizua një ekspeditë në terren për komponentin e sekuestrimit të karbonit. Në këtë aktivitet u angazhuan studentë nga Universiteti Polis, vullnetarë nga ADZM-ja, ekspert mjedisorë lokal dhe ekspertët e Co-PLAN-it. Duke ndjekur parimet e Kërkimit dhe Inovacionit të Përgjegjshëm (RRI), u realizuan matjet e nevojshme në terren për të vlerësuar shërbimin e sekuestrimit të karbonit nga pylli i pishave të Lagunës Kune-Vain. Gjatë këtij procesi, palët e përfshira jo vetëm ndihmuan në krijimin e databazës së të dhënave për komponentin e vegjetacionit, por edhe mësuan sesi realizohen në praktikë matje të tilla. Njohuritë e përvetësuar nga pjesëmarrësit përfshinë: llogaritja e lartësisë së pemës në terren; llogaritja e diametrit të pemës; emërtimi i llojeve të ndryshme të pishave, si në latinisht, si në shqip; vlerësimi i gjendjes aktuale të pemës; hartëzimi i vendodhjes së pemëve; dhe metodologjia shkencore për aktivitete të tilla në terren. Fal këtij aktiviteti, u krijua një databasë e përbërë nga më shumë se 700 pemë, e cila ishte esenciale për vijueshmërinë e vlerësimit të këtij shërbimi ekosistemi të mundësuar nga laguna.



EU4M

BEpërBashkitë

Periudha e Implementimit: 1/06/ 2021 - 31/11/2023

Donator: European Delegation in Albania

Fondi: 2.647.236,75 EUR

Zbatuar nga: NALAS, Network of Associations of Local Authorities of South-East Europe ,Co-PLAN, Institute for Habitat Development, Eco Partners, Association for Local Autonomy and Albanian Association of Municipalities

Zbatuar në: Shqipëri

“BEpërBashkitë” është një projekt i ri i financuar nga Bashkimi Evropian. Synimi i tij është të nxitë potencialin e zhvillimit të bashkive dhe të përmirësojë kushtet socio-ekonomike dhe mjedisore të komuniteteve lokale në Shqipëri. Projekti do të adresojë problemet kryesore që ndikojnë në cilësinë e jetës dhe perspektivat ekonomike të komuniteteve lokale, duke i pajisur ato me standarde evropiane.

Prioriteti i projektit “BE për Bashkitë” është të mbështesë proceset strategjike, që do të lejojnë aktorët e qeverisjes lokale të mobilizojnë burimet për të zbatuar planet dhe strategjitë e tyre. “BE për Bashkitë” do të ndihmojë në kriimin e një praktike më të mirë për qeverisjen lokale dhe qytetarët, në mënyrë që të përcaktojnë se si duhet të përqendrohet në zhvillimin e komuniteteve lokale dhe rolin drejtpërdrejt që Bashkimi Evropian mund të luajë në përmirësimin e qeverisjes dhe cilësisë së jetës së qytetarëve. Nëpërmjet mbështetjes së bashkive në Shqipëri, projekti do të ndikojë në zhvillimin dhe rritjen e tyre në procesin e integrimin në Bashkimin Evropian.

Çfarë bën BE për Bashkitë (EU4M):

1. Adreson problemet themelore që prekin cilësinë e jetës së komuniteteve lokale në Shqipëri përmes investimeve në infrastrukturë dhe përmirësimit të shërbimeve publike.
2. Kontribuon në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin ekonomik lokal dhe për bashkim shoqëror.
3. Mbështet kapacitetet e bashkive për të mbledhur fonde për të financuar projekte investimesh kapitale (siç janë përfshirë në planet e tyre zhvillimore strategjike).
4. Forcon kapacitetet njerëzore të qeverisjes lokale për të absorbuar dhe zbatuar ndihmën financiare nga BE dhe për të rritur shanset e suksesit në instrumente financiare potenciale të tjera të BE.
5. Krijon një model “më të mirë praktikë” për qeveritë dhe qytetarët në lidhje me mënyrën se si duhet të përcaktohen, koordinohen dhe zbatohen prioritetet e zhvillimit.



Professional Fellows

Programi GLC Professional Fellows –
Fuqizimi i Demokracisë së Udhëhequr nga Qytetarët

Periudha e Implementimit: 11.03.2022 - 31.05.2024

Donator: Byroja e Çështjeve Arsimore dhe Kulturore, Departamenti Amerikan i Shtetit

Fondi: 36 540 USD

Organizuar nga: Great Lakes Consortium (GLC)

Zbatuar nga: Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Pro European Network Center for Community Organizing (CCO), Centrul de Resurse pentru participare publică, Civil College Foundation (CCF)

Programi GLC Professional Fellows është një program shkëmbimi ndërkombëtar i dyanshëm, i fokusuar në fushat e qeverisjes dhe shoqërisë civile për udhëheqës të nivelit të mesëm nga pesë vende të Evropës Lindore.

Ai mbështet qytetarët aktivë që të jenë avokatë të fortë për demokracinë e udhëhequr nga qytetarët në Evropën Lindore. Programi e bën këtë duke ofruar zhvillim profesional, digjital dhe të përzier për pjesëmarrësit që të zhvillojnë aftësi për organizimin e komunitetit, angazhimin e qytetarëve, zhvillimin dhe avokimin e udhëhequr nga komuniteti.

Pjesëmarrësit evropianë marrin pjesë në një udhëtim 6-javor, me shpenzime të paguara, në SHBA. Ky udhëtim përfshin një stazh katër-javor në një mjedis profesional (OJQ, institucione publike, etj.).

Më pas, një vizitë reciproke dyjavore sjell mentorë amerikanë në Evropë për të ndihmuar kolegët Evropian në zbatimin e planit të tyre individual 6-9-mujor të një projekti dhe për të ofruar konsultime dhe seminare të përbashkëta.

Qëllimet e programit janë:

- T'u ofrojë udhëheqësve të komunitetit njohuri të zgjeruara teknike, aftësi udhëheqëse dhe lidhje profesionale për të krijuar ndryshime pozitive në komunitetet e tyre;
- Të ndërtojë lidhje të qëndrueshme midis profesionistëve të rinj nga gjashtë vendet partnere.

Co-PLAN, e ka zbatuar këtë program në Shqipëri nga viti 2017. Deri në fund të vitit 2022 ka dy grante aktive nga ky program.

Pesë pjesëmarrës të delegacioneve të vitit 2020 shkuan në Shtetet e Bashkuara

Pesë pjesëmarrës, pjesë e delegacioneve të vitit 2020, përvoja e të cilëve u shty për shkak të pandemisë, kryen praktikën e tyre 4-javore në Shtetet e Bashkuara. Gjatë periudhës Maj – Qershor 2022 Klaudio Hyseni, Elona Xhepa, Kreshnik Hoxha dhe Ardit Vraniçi, kryen praktika me bazë në North Carolina, Massachusetts, New York, New Mexico dhe Ohio, si pjesë e grantit PF21. Më pas ata u kthyen në Shqipëri për të zbatuar planet e tyre individuale të një projekti.

Mentorë nga Shtetet e Bashkuara vizituan Shqipërinë në Shtator 2022

Tre mentorë amerikan, Hector Vaca Cruz, Shazlina Corder dhe Blanca Surgeon, vizituan Shqipërinë për të ndihmuar pjesëmarrësit Shqiptar të zbatojnë planet e tyre të projektit individual. Gjatë këtyre vizitave u mbajt një punëtori nga dy mentorë (Shazlina Corder dhe Blanca Surgeon) me temën “Rifuqizimi i ekonomisë së komunitetit tonë” për të ndarë njohuri mbi zhvillimin ekonomik dhe çfarë mund të bëhet për ta zgjeruar atë nga brenda komuniteteve tona.

Gjatë qëndrimit të tyre u zhvillua edhe një takim mes mentorëve amerikanë me përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë, pjesëmarrës Shqiptar të programit dhe përfaqësues të Co-PLAN.

Pesë Shqiptar shkuan në SHBA si pjesë e grantit PF23

Pesë pjesëmarrës Shqiptar të programit udhëtuan në SHBA për përvojat e tyre personale në periudhën Shtator - Nëntor 2022, si pjesë e grantit PF23. Briseida Gjoza, Enkeleda Sako, Riges Beqiri, Anila Salianji dhe Livia Kreko zhvilluan praktikën e tyre në Massachusetts, New Hampshire, Ohio, North Carolina dhe New York. Pas kthimit, ata filluan të zbatonin planet individuale të projekteve, të cilat do mbështeten nga vizitat e mentorëve të tyre përkatës nga SHBA-ja, që do zhvillohen në vitin 2023.

Ribashkimi i 6-të ndërkombëtar i alumni të programit në Budapest dhe Pecs, Hungari

Nga data 16 - 20 Nëntor 2022, u mbajt ribashkimi i 6-të i alumni të programit në Budapest dhe Pecs, Hungari me 78 pjesëmarrës nga gjashtë vendet partnere të programit. Shqipëria u përfaqësua me 13 pjesëmarrës nga rrjeti i saj i alumni dhe 1 përfaqësues nga Co-PLAN.

Si një event me slognin ‘Sukseset dhe rruga përpara’ ai shërbeu për tre qëllime kryesore: 1) Grumbullimi i rrjetit të alumni për të mësuar nga njëri-tjetri; 2) Festimi i 10 vjetorit të Programit GLC të Professional Fellows; 3) Njohja e pjesëmarrësve më aktiv evropianë dhe amerikanë të programit.





Punësimi Sezonal

Kushte më të mira punësimi për punëtorët sezonal në Shqipëri dhe Kosovë

Periudha e Implementimit: Shtator 2021 – Dhjetor 2023

Donator: GIZ përmes Programit të hapur të fondeve rajonale për Modernizimin e Shërbimive të Bashkive (ORFMMS)

Fondi: 86'064.25 EU + 28'783 EUR (Grant D+ Kosovo)

Zbatuar nga: Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Democracy Plus (D+)

Zbatuar në: Shqipëri dhe Kosovë

Punësimi sezonal zakonisht nuk regjistrohet si kategori specifike punësimi dhe kontribuon në masë të madhe në ekonominë informale. Punëtorëve sezonalë shpesh nuk u sigurohen kushte të përshtatshme pune dhe për shkak të mbikëqyrjes më të vështirë dhe pozicionit të dobët negociues, ata shpesh detyrohen të pranojnë kushte jo të mira punësimi. Duke pasur parasysh natyrën sezonale të punës, të punësuarit janë të angazhuar në baza të rastësishme ose të përkohshme, ndërsa një numër i madh i të punësuarve janë të punësuar në mënyrë joformale.

Nisur nga konteksti, objektivi i përgjithshëm i projektit është të rrisë angazhimin e punonjësve sezonalë në tregun e punës dhe t'u ofrojë atyre mundësi më të mira punësimi përmes një sistemi regjistrimesh elektronike. Në vijim të objektivit të përgjithshëm, secili vend partner në projekt ka zhvilluar objektivat specifike, bazuar në kontekstin specifik, dhe në rastin e Shqipërisë, këto objektiva mund të përmbledhen si më poshtë:

1. Lehtësimi dhe koordinimi i proceseve të Grupit Kombëtar të Punës për të përmirësuar politikëbërjen dhe kuadrin ligjor në lidhje me çështjet e punës dhe veçanërisht ato të punonjësve sezonalë në Shqipëri duke vlerësuar, rishikuar dhe dhënë rekomandime specifike për kuadrin legjislativ;
2. Vlerësimi, përmirësimi dhe përshtatja e sistemit ekzistues të regjistrimit elektronik në Shqipëri për çështjet dhe kërkesat që lidhen me punëtorët sezonalë;
3. Përmirësimi i angazhimit dhe aksesit në tregun e punës të punëtorëve sezonalë duke krijuar mundësi të reja për të gjetur një punë më të mirë.;
4. Sigurimi i asistencës dhe mbështetjes teknike në adoptimin e një qasjeje shumë-nivelëshe, me shumë palë të interesuara në angazhimin, promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit gjatë realizimit të projektit për shpërndarje më të mirë të Politikave të Punëtorëve Sezonalë dhe Zbatimit të Reformës në Shqipëri.
5. Shpërndarja e informacionit mbi rezultatet dhe mësimet e nxjerra për modelin e punësimit të punëtorëve sezonalë në rajon dhe identifikimi i potencialit për reformë në Kosovë

6. Sigurimi i rekomandimeve ligjore të synuara për politikëbërësit për përshtatjen e kornizës ligjore lidhur me punën sezonale/të përkohshme dhe mbështetja gjatë zbatimit të saj, në Kosovë
7. Sigurimi i rekomandimeve dhe vërtetimi i nevojës për një sistem të përshtatur të regjistrimit elektronik në Kosovë, për të mbështetur zbatimin e modelit të ri të punësimit për punë sezonale dhe të përkohshme.

Duke marrë parasysh nevojën e reformimit të punësimit sezonal si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht për sektorin e bujqësisë (Shqipëri dhe Kosovë) dhe atë të turizmit (Shqipëri), duke trajtuar në të njëjtën kohë nivelin e lartë të informalitetit në sektor(ët), duke përmirësuar politikat që lidhen me punën sezonale. dhe zhvillimi i një sistemi regjistrimi të TI-it për punëtorët sezonalë, do të shpaloste mundësi të mira për adresimin e kësaj çështje.

“

**Tregu i punës në Shqipëri
rregullohet me ligj nga
‘Kodi i Punës’, i cili nuk
e njeh punën sezonale
si formë specifike të
angazhimit në marrëdhënie
pune, por e sheh atë si punë
me kohë të pjesshme.**

”



**SI MUND TË
SIGUROJMË
KUSHTE MË TË
PËRSHTATSHME PUNE
PËR PUNËTORËT
SEZONAL NË RAJON?**

Kick off Meeting in Tirana – Drejt Reformës së punësimit sezonal në Shqipëri

Një nga aktivitetet kyçe të organizuara përgjatë muajit shtator (2022), është seminari “Kushte më të mira punësimi për punëtorët sezonalë në Evropën Juglindore”, duke shenjuar dhe fillimin e projektit. Seminari bëri bashkë partnerë dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet qeveritare shqiptare si përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në rolin e institucionit homolog kyç, Ministria e Bujqësisë dhe Ministrisë së Turizmit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe përfaqësues nga Unioni i Prodhuesve Shqiptarë. Pjesëmarrësit në takim ranë dakord mbi domosdoshmërinë e zgjidhjes së çështjeve të punësimit sezonal në Shqipëri dhe theksuan bindjet e tyre për përfitimet që reforma do të sjellë në formalizimin e sektorit bujqësor dhe turistik. Nga ana tjetër, një qasje sektoriale për punëtorët sezonalë është hapi i parë vendimtar i cili do të çojë më tej reformimin edhe në sektorë të tjerë.

Takime mes aktorësh institucional në Kosovë – Hartimi i Analizës Kombëtare të Punësimit Sezonal

Pas një pune përgatitore për analizimin e situatës me punëtorët sezonalë në Kosovë, më 19 maj u mbajt një takim fillestar me të gjitha palët e interesuara të identifikuar në ambientet e GLZ-it në Kosovë.

Megjithëse, projekti u prezantua më parë për të gjithë palët e interesuara të identifikuar individualisht, qëllimi i trajnimit ishte të bënte bashkë të gjithë palët e interesuara për të:

- prezantuar projektin dhe qasjen e tij rajonale së bashku me prezantimin e praktikave të shkëlqyera në rajon, gjendjen aktuale dhe gjetjet e para rreth punësimit sezonal në Kosovë në sektorin e bujqësisë;
- diskutuar me palët e interesuara për rëndësinë e nxitjes së reformës së punëtorëve sezonalë në Kosovë dhe sfidat ndaj reformës;
- drejtuar bashkëpunimin ndërmjet aktorëve institucionalë dhe formimin e Grupit të Punës për Vendin për të ndjekur projektin;

Pjesëmarrësit në takim u pajtuan për rëndësinë e lartë të reformave të punësimit sezonal në Kosovë, veçanërisht në sektorin e bujqësisë. Kjo bëhet veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se Kosova ndërkohë është duke punuar për ndryshimet e reja të Ligjit të Punës.



Emergjencat Civile

Projekti për komunikimin e emergjencave -
Ndërgjegjësimi për rrezikun dhe sigurinë e qytetarëve

Periudha e Implementimit: 01.01.2021 - 19.07.2022

Donator: Rajoni Friuli Venezia Giulia

Fondi: 50.000 EUR

Zbatuar nga: Poli Teknologjik i Pordenone SCPA, OGS - Instituti Kombëtar i Oqeanografisë dhe Gjeofizikës së Aplikuar, UNAGA - Bashkimi Kombëtar i Shoqatave të Gazetarëve në Bujqësi, Ushqim, Mjedis, Territor, Pyje, Peshkëtari, dhe Energjitë Rinovueshme

Zbatuar në: Shqipëri

Projekti u fokusua në krijimin e kërkesave për një menaxhim autonom dhe të qëndrueshëm të emergjencave që lidhen me rreziqet natyrore në shkallë kombëtare në të ardhmen, drejt harmonizimit me standardet e vendosura nga BE. Qëllimi ishte të kontribuonte në rritjen e ndërgjegjësimit dhe reagimit të popullatës, duke promovuar komunikim efektiv në nivele të ndryshme (nga të kuptuarit e aspekteve shkencore deri tek menaxhimi i lajmeve të rreme) që u mundëson qytetarëve të marrin vendime të ndërgjegjshme për mbrojtjen e vetes dhe të tjerëve. Përfituesit e drejtpërdrejtë ishin komunikuesit (p.sh., gazetarët dhe zyrtarët e medias në përgjithësi), ndihma e parë dhe vendimmarrësit shqiptarë të përfshirë në menaxhimin e emergjencave, si dhe qytetarët (studentët në veçanti) që u angazhuan dhe përdorën produktet (trajnime, evente publike të shpërndara përmes videove dhe materialeve informative/edukative) të zhvilluara në kuadër të projektit.

Projekti kishte për qëllim arritjen e objektivave të mëposhtëm:

- Analiza paraprake e kontekstit në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut sizmik dhe tsunami;
- Përcaktimi i kontekstit dhe kufijve ekzistues në lidhje me komunikimin e rreziqeve natyrore;
- Vlerësimi i ndërgjegjësimit të popullatës dhe grupeve specifike (gazetarë, politikëbërës dhe përgjegjës të parë) në lidhje me rreziqet natyrore, veçanërisht në lidhje me rrezikun sizmik dhe tsunami;
- Identifikimi i nevojave bazë;
- Përcaktimi i një strategjie komunikimi dhe veprimesh që do të zbatohen para dhe gjatë emergjencës, duke marrë parasysh problemet e identifikuar dhe kontekstin specifik social dhe kulturor;
- Eksperimentimi i teknologjive inovative për trajnime / komunikim efektiv, të aksesueshëm nga distanca dhe nga një audiencë e gjerë përdoruesish.

**SI DUHET
RAPORTUAR
NË KOHË
EMERGJENCASH
CIVILE?**



Kurs trajnimi mbi Komunikimin në Emergjencë: Ballafaqimi me Tërmete dhe Tsunami

Pandemia e COVID-19 evidentoi kapacitetin e pamjaftueshëm të shoqërisë në të gjitha nivelet për t'iu përgjigjur situatave emergjente duke nxjerrë në pah një ndërgjegjësim të ulët për rrezikun dhe mungesën e një strategjie të qartë dhe të përbashkët komunikimi institucional. Komunikimi joadekuat, i paqartë ose kontradiktor ishte një nga faktorët që ndonjëherë rrezikonte efektivitetin e masave të miratuara edhe në vendet ku ekzistojnë planet dhe iniciativat e menaxhimit të emergjencave.

Shkolla e Trajnimit mbi Komunikimin e Emergjencave, synoi t'ju sigurojë profesionistëve në komunikim, përfaqësuesve të ndihmës së parë, përgjegjësve në menaxhimin e emergjencave, si dhe shkencëtarëve në rolin e tyre si “ofrues të informacionit”, sfondin e nevojshëm për të vendosur bazën për një kuptim të përbashkët të fenomenit dhe për komunikim adekuat të informacionit shkencor tek popullata. Gjithashtu u hulumtuan mundësitë e ofruara nga “Shkenca Qytetare”, përkatësisht informacioni i ofruar nga qytetarët në drejtim të përmirësimit të vlerësimit të rreziqeve. Gjatë shkollës së trajnimit, një modul specifik trajtoi përdorimin e realitetit virtual si një mjet komunikimi mediatik për aspektet shkencore. Në fakt, të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë të zhyten në realitetin virtual 3D si një nga mjetet e mundshme për të rritur ndërgjegjësimin për situatat emergjente që lidhen me rreziqet natyrore.





transparenca

Raporti i Kontrolluesve të Pavarur Për Drejtorin Ekzekutiv të Institutit Co-PLAN për Zhvillimin e Habitatit

Kemi kontrolluar bilancin e Institutit Co-PLAN për Zhvillimin e Habitatit (në vijim të quajtur “Organizata” ose “Co-Plan”) për periudhën deri më 31 dhjetor 2022. Strukturat Menaxheriale të Co-Plan janë përgjegjëse për përgatitjen dhe paraqitjen e të dhënave financiare të sakta. Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto të dhëna financiare në bazë të kontrolleve tona.

Kemi kryer kontrollin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit. Nën këto standarde, jemi të detyruar të planifikojmë dhe të kryejmë kontrollin për të siguruar siguri të arsyeshme në lidhje me faktin se të dhënat financiare nuk përmbajnë asnjë gabim apo devijim të rëndësishëm. Një kontroll përfshin zbatimin e disa procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me shumën dhe shpalljet në të dhënat financiare. Kontrolli përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe vendimeve të rëndësishme të marra nga strukturat menaxheriale, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të paraqitjes së situatës financiare. Ne besojmë se dëshmia e kontrollit të marrë nga ne ofron një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë mendimin tonë.

Këto të dhëna financiare përgatiten në bazë të një kostoje historike, nën parimin e regjistrimit të dyfishtë në përputhje me metodën “kontabilitet i fondeve,” e cila ndryshon nga Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar dhe legjislacioni i Kontabilitetit Shqiptar.

Sipas vlerësimit tonë, të dhënat financiare japin një pozicion financiar të vërtetë dhe të saktë të Organizatës në datën 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe rrjedhat e ardhshme për vitin e përfunduar, në përputhje me metodën “kontabilitet i fondeve”.

Independent Auditor's Report

To the Board of Directors of "Co-PLAN" - Institute for Habitat Development"

Opinion

We have audited the financial statements of "Co-PLAN" - Institute for Habitat Development" (hereafter referred as the "Organization"), which comprise the statement of financial position as at 31 December 2022, the statement of activities, the statement of cash flows for the year then ended, notes and appendices to the financial statements, including a summary of significant accounting policies

In our opinion, the accompanying financial statements present fairly, in all material respects, the financial position of the Organization as at 31 December 2022, its financial performance and its cash flows for the year then ended in accordance with the National Accounting Standard for Non-Profit Organizations in Albania.

Basis for Opinion

We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing (ISAs). Our responsibilities under those standards are further described in the Auditor's Responsibilities for the Audit of the Financial Statements section of our report. We are independent of the Organization in accordance with the International Ethics Standards Board for Accountants' Code of Ethics for Professional Accountants (IESBA Code) together with the ethical requirements that are relevant to our audit of the financial statements in Albania, and we have fulfilled our other ethical responsibilities in accordance with the IESBA Code. We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion.

- Conclude on the appropriateness of management's use of the going concern basis of accounting and, based on the audit evidence obtained, whether a material uncertainty exists related to events or conditions that may cast significant doubt on the Organization's ability to continue as a going concern. If we conclude that a material uncertainty exists, we are required to draw attention in our auditor's report to the related disclosures in the financial statements or, if such disclosures are inadequate, to modify our opinion. Our conclusions are based on the audit evidence obtained up to the date of our auditor's report. However, future events or conditions may cause the Organization to cease to continue as a going concern.
- Evaluate the overall presentation, structure and content of the financial statements, including the disclosures, and whether the financial statements represent the underlying transactions and events in a manner that achieves fair presentation.

We communicate with those charged with governance regarding, among other matters, the planned scope and timing of the audit and significant audit findings, including any significant deficiencies in internal control that we identify during our audit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tirane, Shqipëri

27/06/2023

Adrian Jashari, FCP
Adrian



Co-PLAN Institute for Habitat Development Statement of financial position for the year ended December 31, 2022 Amounts are expressed in EURO unless otherwise stated

	Note	31 December 2022	31 December 2021
Assets		1,662,773	977,740
Cash and cash equivalents	4	-	626,358
Term Deposit	5	226,242	252,743
Subsidiary/partner	7	351,339	118,784
Prepaid insurance	8	266,350	15,855
Other receivables	9	42,910	20,145
		2,507,885	2,035,885
Fixed assets			
Total assets			977,740
Liabilities and project funding	10	317,132	181,671
Liabilities	11	1,189,324	1,152,041
Deferred income			
		1,405,256	1,333,712
Total liabilities			977,740
Net assets		1,192,329	977,849
Unrestricted net assets	12	1,192,329	977,849
Unrestricted Net Assets		2,507,885	2,531,661
Total Liabilities and Net Assets			

The Statement of Financial Position is to be read in conjunction with the notes set out on pages 8 to 22 and forming part of the financial statements.

These financial statements were approved by the Management Board of Co-Plan - Institute for Habitat Development on June 27, 2023.

Adrian Jashari
Adrian Jashari
Executive Director

Adrian Jashari
Adrian Jashari
Finance Manager



© Ky Raport, përfshirë imazhet dhe tekstin, nuk mund të riprodhohet ose ndryshohet, në tërësi ose pjesërisht, pa miratimin paraprak të Co-PLAN.

Co-PLAN 2022.